

Mbiemrat e shqiptarëve të Kosovës – prejardhja dhe shpërndarja rajonale (Origin and regional distribution of Kosovo Albanian surnames)

Ali Caka, Nebi Caka

Universiteti i Prishtinës (University of Prishtina)

Studime shoqërore, nr. 3, 2016, ASHAK

Ali CAKA, Prishtinë
Nebi CAKA, Prishtinë

PREJARDHJA DHE SHPËRNDARJA RAJONALE E MBIEMRAVE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS

KDU 811.18'373.23

Abstrakt

Në dallim nga popujt e tjerë të Evropës, mbiemrat te shqiptarët janë relativisht të vonë. Gjatë Mbretërisë Jugosllave shumica e shqiptarëve të Kosovës kanë qenë të detyruar nga pushteti që mbiemrit të tyre t'u shtojnë edhe mbaresën sllave –*iq* ose –*viq*. Pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarëve të Kosovës u është lejuar t'i ndryshojnë mbiemrat e tyre, gjë që shumica edhe e kanë bërë. Pjesa më e madhe e familjeve të shqiptarëve në Kosovë i kanë mbiemrat e sotëm që nga kjo kohë. Ndryshimi i mbiemrit është i lejuar me ligj edhe tash dhe kemi raste të ndryshimit të mbiemrit edhe pas luftës së fundit në Kosovë, d.m.th. pas vitit 1999. Në këtë punim janë marrë për shqyrtim mbiemrat nga regjistra të ndryshëm të popullsisë, me rreth 1.500.000 individë të ndryshëm. Është bërë klasifikimi i mbiemrave dhe është paraqitur edhe lista e 100 mbiemrave më të përdorur në Kosovë, listë kjo e cila është krahasuar me 100 mbiemrat më të përdorur në Shqipëri. Disa nga mbiemrat më karakteristike janë ilustruar me historinë e prejardhjes së këtyre mbiemrave nga vetë bartësit e tyre. Janë anketuar, me anë të postës elektronike, një numër i konsideruar i personave, të dy gjinive, nga moshë 24 vjeç deri më 70 vjeç, dhe nga ta është kërkuar ta japin versionin e tyre të prejardhjes së mbiemrit ose emrit familjar të tyre dhe mundësisht të shënojnë trungun familjar. Kuptohet se jo të gjithë i janë përgjigjur kësaj 'ftese'. Një numër i përgjigjeve jepet në këtë punim, e përgjigjet e tjera do të përdoren në një punim më gjithëpërfshirës, të tipit monografik, lidhur me këtë temë. Përgjigjet në shumicën e rasteve janë 'versioni zyrtar' i familjes meqë të anketuarit janë këshilluar edhe me anëtarët e tjerë të familjes, rëndom i ati dhe gjyshi, por dhe ndonjë axhë më i moçëm. Shumica e të anketuarve e kanë dhënë edhe trungun familjar që në disa raste shkon deri në 15 breza, që përfshin një hark kohor prej 500 vjetëve. Disa e kanë dhënë edhe përkatësinë fisnore.

Në fund është dhënë edhe shpërndarja rajonale e 100 mbiemrave më të shpeshtë të shqiptarëve të Kosovës.

Fjalët çelës: mbiemrat e shqiptarëve, klasifikimi i mbiemrave, prejardhja e emrave familjarë, 100 mbiemrat më të përdorur shqiptarë

HYRJE

Në dallim nga popujt e tjerë të Evropës, mbiemrat të shqiptarët janë relativisht të vonë. Në Angli, për shembull, mbiemrat janë miratuar në masë të madhe ndërmjet shekujve 11 dhe 16. Gjatë Perandorisë Osmane, shumica e popullsisë jo vetëm në vilajetet shqiptare, por edhe në tërë perandorinë nuk kanë pasur mbiemra. Ata u vendosën në masë të gjerë vetëm pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, kur dhe filluan të kryhen regjistrimet e para të popullsisë në shtetin posa të formuar. Në popullatën shqiptare të Kosovës, të pushtuar nga Serbia, me qëllim të asimilimit dhe të dëbimit të saj nga trojet e veta, u ushtrua terror shtetëror, ndër të tjera duke u shtuar mbiemrave të shqiptarëve mbaresat sllave *-iq* ose *-viq*. Kështu Cufa (nga: Isuf) u bë Cufiq, e Hasani u bë Hasanoviq. Pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarëve të Kosovës u lejua t'i ndryshojnë mbiemrat e tyre, gjë që shumica edhe e bënë dhe pjesa më e madhe e familjeve të shqiptarëve në Kosovë i kanë mbiemrat e sotëm nga kjo kohë, rëndom duke ua hequr prapashtesën sllave *-iq/-viq*. Por kemi raste kur kryefamiljari ka marrë mbiemër a emër familjar krejtësisht të ri. Kështu kryefamiljari Bajram Beqiri nga Vuçitërna me vetëdëshirë e ka ndryshuar mbiemrin *Beqiri* në *Shotani* më 31 VIII 1947 në 'Drejtoratin e punëve të Mbrendshme pranë Këshillit Ekzekutiv Krahinuer të Këshillit populluer Krahinuer të KAKM' (nga vendimi nr. 79/B lëshuar të lartpërmendurit). Këtë mbiemër, sipas familjarëve, si duket e ka përzgjedhur se kanë pasur shumë shota.

Arsyetimi: "Simbas Nenit 1 të Urdhnit të Këshillit Ekzekutiv Krahinuer të K.A.K.M. shpallë në Fletoren Zyrtare" të K.A.K.M. me 25 Shtatuer 1946, të gjithë banorët e kombësis Shqiptare në territorin e krahinës autonome të Kosovë Metohis duhet t'a caktojnë përgjithmonë dhe ta përdorin vazhdimisht vetëm një emën familjar. Ky emën nuk mund të ndryshohet pa vendimin paraprak të pushtetit kompetent."

Njëjtë, ka vepruar edhe familja e Jamin Spahiut dhe e kushëririt të tij Beqirit nga Prizreni, të cilët po në atë kohë e kanë marrë mbiemrin e ri *Shalqini*, sipas fshatit Shalqin në Hasin e Shqipërisë, me të cilin kanë pasur marrëdhënie të mira [sipas tregimit të Ermir Shalqinit, të birit të Ismail Ragip Jamin Spahiut/Shalqinit].

Po ashtu edhe familja e Daut Malokut, nga Prishtina, me prejardhje nga Mareci i Prishtinës, e ardhur këtu nga Ramabaja, mbiemrin *Maloku* e kanë nga kjo kohë, pikërisht nga viti 1948, kur e

kanë ndryshuar mbiemrin Jashari në Maloku [Daut Maloku, 70 vjeç nga Prishtina].

Edhe familja me ish-mbiemrin *Avdiu* nga fshati Greiçec i Suharekës (Therandës), lagjja Bungu, mbiemrin Bungu që e kanë tash e kanë nga kjo kohë, sipas gojëdhënës, sipas qëndrueshmërisë ‘si bungu’ ndaj torturave të pushtetit të atëhershëm të një të pari të tyre, ose sipas një lisi (bungu) shumëvjeçar dhe shumë të lartë dhe të trashë në lagjen e tyre [Fadil Bungu, 43 vjeç].

Kemi ndërrime të mbiemrave edhe më vonë, p.sh. *Dobra* bëhet *Gashi*. Ndërrim mbiemri kemi edhe pas luftës së fundit në Kosovë, p.sh. *Shehaj* bëhet *Shehu*.

Variantet e disa mbiemrave tregojnë të dhëna shtesë. Kështu, p.sh. në Kosovë mbiemrin *Komani* (336) e bartin kryesisht pjesëtarët e komunitetit katolik, ndërsa mbiemrin *Komoni* (178) – pjesëtarët e komunitetit mysliman; *Habibaj-t* (36) janë vendas, ndërsa *Habipaj-t* (5) janë të ardhur nga Shqipëria. Edhe numri i vogël i bartësve të disa mbiemrave tregon se ato familje kanë ardhur jo shumë moti në Kosovë, si: *Gjevori* (6) – nga Elbasani, ose *Ushaku* (5) – nga Ulqini.

1. PREJARDHJA E MBIEMRAVE

Sipas origjinës a motivimit të krijimit të tyre, mbiemrat e njerëzve rëndom klasifikohen në katër/pesë kategori të mëdha:

1. **Mbiemrat patronimikë (patronimet)** – Mbiemrat që tregojnë vijimësinë, birërinë a prejardhjen e drejtpërdrejtë të bartësve të tyre nga personi emrin (e plotë ose të shkurtuar) e të cilit e mbajnë si mbiemër, rëndom ky i ati, gjyshi a stërgjyshi i tyre, si: *Ademi* – *Dema/Demi*, *Bajrami* – *Bajra*, *Hasani* – *Cana*, *Hyseni* – *Ceni*, *Ibrahimi* – *Ibra/Braha*, *Januzi* – *Nuza*, *Islami* – *Lama*, *Jakupi* – *Kupa/Jupa*, *Jusufi* – *Cufa*, *Maksuti* – *Maka*, *Mehmeti/Muhameti* – *Meta*, *Neziri* – *Neza*, *Ramadani* – *Rama/Dana*, *Rexhepi* – *Rexha/Rexhaj*, *Sejdiu* – *Sejda*, *Sylejmani* – *Syla*, *Shaqiri* – *Shaq*, *Zeneli* – *Nela*, *Zeqiri* – *Zeqa* etj.
2. **Mbiemrat topografikë** – Mbiemrat që tregojnë vendbanimin, fshatin, qytetin a krahinën (fisin, bajrakun) prej nga mendohet se e kanë prejardhjen të parët e bartësve të mbiemrit, si: *Dibra*, *Peja*, *Shkodra*; *Drenica*, *Llapi*, *Mati*, *Toplica*; *Gruda*, *Hoti*, *Berisha*, *Krasniqi* etj., po dhe *Dibrani*, *Shkodrani*, *Ulqinaku* etj., ose ndonjë koncept gjeografik, si: *Fusha*, *Kodra*, *Pylla* etj.

3. **Mbiemrat sipas profesionit ose gradës** – Mbiemrat që tregojnë zanate dhe profesione ose tituj fetarë e zyrtarë a grada ushtarake, si: *Berberi, Kasapi, Kovaçi, Nallbani, Terziu; Agai, Kadiu; Myftiu, Spahiu; Hoxha, Myderrizi, Shehu; Bylykbashi, Bimbashi, Delibashzade* etj.
4. **Mbiemrat sipas gallapit a nofkës** – Mbiemrat që janë formuar në formën e nofkës a të llogarit të ndonjë paraardhësi të bartësit të mbiemrit, si: *Çollaku, Gunga, Qorri, Shurdha, Topalli* etj.
5. **Mbiemrat matronimikë (matronimet)** – Mbiemrat që tregojnë vijimësinë, birërinë a prejardhjen e drejtpërdrejtë të bartësve të tyre nga një grua, emrin (e plotë ose të shkurtuar) e të cilit e mbajnë si mbiemër, rëndom kjo nëna, gjyshja a stërgjyshja e tyre si: *Hasimja, Havolli, Maraj* etj.

Kuptohet se mjaft mbiemra mbeten pa u kategorizuar në njërën prej këtyre 5 kategorive për shkak se shpesh është e vështirë të gjendet etimologjia e mbiemrit ose motivimi i tij.

Disa mbiemrave nuk mund t'u caktohet prejardhja vetëm në bazë të paraqitjes fonetike, pa ndihmën e bartësve më të vjetër të atij mbiemri, si p.sh. *Dinaj* sipas katragjyshit (brezi i pestë) *Dina* < *Sadik* [Flamur Dinaj, 47 vjeç, nga Raushiqi i Pejës]

Siç shihet kategoritë e mësipërme kanë nënndarjet e tyre, të cilat do t'i përdorim më poshtë për të paraqitur më mirë motivimin e formimit të mbiemrave të shqiptarëve të Kosovës.

2. KATEGORITË E MBIEMRAVE

2.1 Mbiemrat patronimikë

Mbiemrat që tregojnë vijimësinë a birërinë, përkatësisht prejardhjen e drejtpërdrejtë të bartësve të tyre nga një i parë i tyre, janë më të shumtit në Kosovë.

- Sipas emrit të një të pari të bartësve të mbiemrit, kemi mbiemra si:

Abazi, Ademaj, Ademi, Ahmeti, Ajeti, Aliu, Arifi, Asllani, Avdiu, Avdyli, Azemi, Bajrami, Balaj, Behrami, Beqiri, Bislimi, Brahimi, Demiri, Emiri, Fazliu, Hajdari, Hajdini, Halili, Halimi, Haliti, Hasani, Haziri, Hyseni, Ibrahim, Idrizi, Imeri, Islami, Ismajli, Isufi, Jakupi, Jashari, Jusufi, Kadriu, Latifi,

Maliqi, Mehmeti, Miftari, Murati, Musa, Musliu, Mustafa, Neziri, Osmani, Qerimi, Rama, Ramadani, Rexha, Rexhaj, Rexhepi, Rrahmani, Sadiku, Sahiti, Salihu, Sejdiu, Selimi, Selmani, Sinani, Syla, Sylejmani, Shabani, Shaqiri, Tahiri, Uka, Ukaj, Veseli, Zeka, Zeneli, Zeqiri etj.

Mbiemrat sipas emrit të babait tash janë tepër të rrallë, si p.sh. vëllazërit Murtezai nga Gjakova: *Masar Murtezai* (1922) dhe *Ekrem Murtezai* (1931).

- Kryesisht në një pjesë të Dukagjinit, por dhe në tërë Kosovën, një pjesë e madhe e mbiemrave që tregojnë vijimësinë a birërinë, mbarojnë me **–aj**. Në korpusin tonë na dalin rreth 1100 mbiemra me **–aj**. T’i përmendim vetëm ata me mbi 500 paraqitje):

Ademaj, Ahmetaj, Aliaj, Alijaj, Arifaj, Avdijaj, Bajramaj, Balaj, Begaj, Bekaj, Beqaj, Beqiraj, Bibaj, Binakaj, Blakaj, Brahaj, Brahimaj, Cakaj, Canaj, Çoçaj, Dakaj, Dautaj, Dedaj, Demaj, Dervishaj, Dodaj, Dreshaj, Duraj, Elezaj, Fetahaj, Fetaj, Gecaj, Gegaj, Gjocaj, Gjokaj, Gutaj, Hadergjonaj, Hajdaraj, Hakaj, Halilaj, Halitaj, Hamzaj, Haradinaj, Hasanaj, Haxhaj, Haxhijaj, Haziraj, Himaj, Hodaj, Hoxhaj, Hulaj, Hysenaj, Idrizaj, Imeraj, Islamaj, Jahaj, Januzaj, Kadriaj, Kadrijaj, Kicaj, Kukaj, Kurtaj, Latifaj, Lekaj, Likaj, Lokaj, Loshaj, Lushaj, Mahmutaj, Maksutaj, Markaj, Mataj, Mavraj, Mazrekaj, Mehmetaj, Memaj, Metaj, Muçaj, Mujaj, Mulaj, Muqaj, Musaj, Mustafaj, Neziraj, Nrecaj, Osaj, Osmanaj, Pepaj, Popaj, Pulaj, Qenaj, Qorraj, Racaj, Ramaj, Ramosaj, Rexhaj, Rexhepaj, Sadikaj, Sahitaj, Salihaj, Selimaj, Selmanaj, Sopaj, Sylaj, Shabanaj, Tafilaj, Tahiraj, Temaj, Tolaj, Ukaj, Veselaj, Zekaj, Zenelaj, Zeqiraj, Zogaj.

Është interesant si shpjegohet prejardhja e mbiemri *Hulaj* (616) nga vetë bartësit e këtij mbiemri. Sipas Astrit Hulajt (nga fshati Hulaj i Deçanit), në vendin ku ndodhet ky fshat ka pasur lisa të gjatë dhe kërpnaja (kulpra) që janë përdorur për hulaja (luhaja, kolovajza) nga të rinjtë e fshatit Pobergjë (Vokshi i Ri). Pasi kanë filluar të ndërtohen shtëpi në atë pjesë, ato kanë filluar t’i identifikonin duke thënë ‘po shkojmë te hulajat’ dhe në këtë mënyrë thonë se i ka mbetur emri këtij fshatit, po dhe mbiemri Hulaj (Këtë version na tregoi edhe Haki Hulaj, po nga ky fshat.)

- Një tip i veçantë i mbiemrave të vijimësisë janë mbiemrat që tregojnë përkatësinë, e që dalin me mbaresën **–olli** (nga turq.

oğlu. ‘i biri’). Më poshtë po japim vetëm ata me mbi 100 paraqitje, nga rreth 500 sa dalin në korpusin tonë:

Bakolli, Basholli, Begisholli, Begolli, Bekolli, Boqolli, Bucolli, Cakolli, Canolli, Demolli, Dervisholli, Devolli, Dukolli, Gjokolli, Gjinolli, Hakolli, Hasolli, Havolli, Hazrolli, Hodolli, Humolli, Hykolli, Jupolli, Kadolli, Kadrolli, Kafexholli, Kamerolli, Kasapolli, Kasolli, Kerolli, Kodrolli, Kololli, Kurtolli, Lutolli, Maholli, Makolli, Mangjolli, Meholl, Mejinolli, Mekolli, Metolli, Muçolli, Mulolli, Muqolli, Musolli, Pacolli, Perolli, Pintolli, Plakolli, Pushkolli, Qorrolli, Ramusholli, Rizvanolli, Rukolli, Rrustolli, Sedolli, Sertolli, Smakolli, Softolli, Shamolli, Shatrolli, Sheholli, Shosholli, Shukolli, Shumolli, Tafolli, Tasholli, Tërmkolli, Vrajolli, Zekolli, Zhugolli.

Sipas një tregimi, që asht bartur gojë në gojë nëpër breza, Lagjet e Marecit (Marevcit), fshat afër Prishtinës, i cili karakterizohet me mbiemra me **-olli**, rrjedhin nga djemtë e të parit të tyre (Ahmat-it): Maka, Paca, Caka dhe Cana, prej të cilëve kanë mbetur mbiemrat *Makolli, Pacolli, Cakolli* dhe *Canolli* [Vesel Makolli, 2016]

- Në anën e Deçanit, janë karakteristikë mbiemrat e përbërë prej dy (madje dhe prej tre) emrave personash a individësh. Në korpusin tonë, të tillë dalin mbi 200:

Ahmagjekaj, Ahmaxhekaj; Ahmetgjekaj, Ahmetxhekaj; Alibajra, Alibajramaj; Alibalaj, Alibali; Alibegu; Alidema, Alidemaj, Alidemi; Alidini; Aligjiku; Alihafëzi; Alihajdaraj, Alihajdari; Alihusaj; Aligega; Alijupi; Alimani; Alimehaj; Alimetaj; Alimusa, Alimusaj; Alirifa, Alirifini; Aliriza; Alisallahu; Alishani; Alitjaha; Alizoti; Asanalijaj; Avdimetaj; Axhanela (nga: axha + Zenel/Nela); Axhidema; Axhimusa; Axhirexha; Baldeda, Baldedaj; Balibasha; Balidemaj; Dançeli; Danhoxha; Dansefa; Demaliaj, Demalijs, Demalijaj; Demëahmeti; Demëbogaj; Demelezi; Demhasaj; Demjaha; Demukaj; Dinarama; Gjevelekaj; Gjikota, Gjikokaj; Gjokolaj; Gjoleka; Gjolleshaj, Gjonlleshaj; Gjonbalaj; Gjovelekaj; Gjurgjeala, Gjurgjeali, Gjurgjiali; Hadergjonaj, Hadërgjonaj; Hasametaj, Hasanmetaj; Himaduna; Himbeqa; Himdula; Himtahiri; Hykosmanaj, Hykosmani, Hykosmoni; Hyselekaj, Hysenlekaj; Hysvukaj, Iberdemaj, Ibërdemaj; Iberhysaj, Ibërhysaj, Jahdauti, Jahëdauti; Jahkurti; Jahmurataj; Kolgecaj, Kolgeci; Kolgjeraj; Kolgjini; Kukalaj; Kuklecaj,

Kukleci; Kurhasani; Kurhasi, Kurhasku; Kurmehaj; Kurmetaj; Kurpalaj, Kurpali; Kursani, Kursoni; Kurtaliu; Kurtbogaj; Kurtpalaj; Kurtsmajli; Kurtulaj, Lamaxhema; Limanmera; Lulgjuraj; Mahmudehaj; Mahmudemaj; Malazogu; Malneziri; Mangjollaj, Mangjolli, Manxhuka, Mangjuka, Mangjuki, Manxhuki, Mangjuku; Manrecaj; Maralusha, Maralushaj; Margataj; Margegaj; Margilaj; Marklushaj; Markprekaj, Marprenkaj; Marleka, Marleku; Mehuka, Mehukaj, Memetukaj; Metahysaj; Metarapi; Metbala; Metdervishi; Metkamberi; Metrama; Metujkaj; Muçkurtaj; Muhadri; Mulamisini; Mularama; Mulhaxha; Musëshabanaj, Musshabanaj; Mushkolaj, Nikollbibaj; Nikollprekaj, Nikollprenkaj; Nikprelaj; Nikulaj; Osdautaj; Perçuku, Perquku, Përquku; Perdeda, Perdedaj, Përdedaj; Pergega, Përgega, Pergegaj, Përgegaj; Pergjegjaj, Përgjegjaj; Pergjoka, Përgjoka; Pergjoni, Përgjoni; Perjuci; Perkola, Përkola, Perkolaj, Përkolaj; Perlaska, Përlaska, Perlaskaj, Përlaskaj; Perlleshi, Përlleshi; Perndrekaj; Pernoka, Përnoka, Pernokaj, Përnokaj; Pernocaj; Perpalaj; Pervorfi; Perzefaj, Përzefaj; Prelvukaj; Prendrecaj; Prendrekaj; Prengjoka; Prenklushaj; Prenkoçaj; Prenkolja; Prenkolnikaj (= Prenë + Kolë + Nikë); Prenkpalaj, Prenkëpalaj; Prenlushaj; Prenpalaj; Prenrecaj; Prenrekaj; Ramosaj; Rexhahmetaj; Rexhbeqaj, Rexhëbeqaj, Rexhbeçaj, Rexhëbeçaj; Rexhbogaj, Rexhëbogaj; Salauka, Saliuka, Saliuku; Shabanhaxhaj; Tafarshiku; Tahirsylaj; Tahirukaj, Tishukaj, Tishuki; Tunprekaj, Tunprenkaj, Ukëperaj, Ukësmajli, Uksmali, Uksmaili, Uksmajli, Ukzmaili, Ukzmajli, Ukzmali (= Ukë + Ismajl); Ukëzeka; Ukgjini; Ukhagjaj, Ukhaxhaj, Ukëhagjaj, Ukëhaxhaj; Ukëhajdaraj; Ukimeraj, Ukimeri; Ukmata; Ukperaj; Ukzeka; Xhevelekaj, Xhevukaj; Xhikokaj; Xhikolaj; Ymerhalili.

Shembull i trungut të një familjeje të kësaj ane: Familja **Hasanmetaj** (fisi Krasniqe, katundi: Strellc, Deçan): Redon (1995) < Miftar (1956) < Shaban (1914-1996) < Azem (1885-1952) < Sylë < Nezir < Haredin < **Hasan** < **Metë** < Lekë.

Mbiemrat e këtij tipi janë karakteristikë edhe për banorët e ardhur në Kosovë nga Plava e Gusia. Sipas Musë Prelvukajt, i fisit Kelmend, nga Martinaj i Plavës, në Martinaj janë mbiemrat: Prelvukaj, Hasangjekaj, Balidemaj dhe Lecaj. Prelvukajt,

Hasangjekajt dhe Lecajt janë nga Vukli kurse Balidemajt janë nga Selca Kelmend. Ja trangu i familjes së tij: Gjini – Genci – Musa – Zeneli – Mehmeti – Brahimi – Kasemi – Çuka – Jaha – Uka – Hasani – **Prela – Vuka** – Martini – Nika.

Si mbiemra të vijimësisë mund të merren edhe mbiemrat e mëposhtëm:

- Mbiemrat me **–aga** (titull ushtarak dhe çifligari):

Abazaga, Abdulaga, Abdylaga, Agagjyshi, Aga, Agai, Agaj, Agallari, Ajdaraga, Aliaga, Avdilaga, Avdulaga, Avdullaga, Avdylaga, Bajramaga, Bejazaga, Damonaga, Dautaga, Dervishaga, Hajdaraga, Hajrullaaga, Hajrullaga, Hamitaga, Ibishaga, Ibrahimaga, Jahjaga, Jahjagaj, Jajaga, Karamanaga, Malushaga, Margagaj, Saliagaj, Tahiraga, Tairaga, Ymeraga.

- Mbiemrat me **beg** a **begolli** (titull çifligari):

Alibegu, Allajbegu, Begolli, Begi, Begleri, Begu, Begzadi, Begzati, Kajabegolli, Karabegu, Kasëmbegu, Lamabegu, Musbegu, Muzbegu, Nimanbegu, Salabegolli, Sallabegolli, Tahirbegolli, Velibegu, Zijabegu.

Në Kosovë familja më e njohur me origjinë bejlere janë Mahmudbegollët e Pejës, të cilët më 1941 e hoqën emrin e të konvertuarit të parë, Mahmud, që i dallonte nga familjet e tjera bejlerësh pejane (si Kajabegolli, Sallabegolli e Tahirbegolli) dhe mori mbiemrin Begolli. Sipas Mithat Q. Begollit, “ky ndryshim është bërë me qëllim që të theksohet origjina e mirëfilltë e kësaj familjeje, e cila në kohën e sundimit të Perandorisë Osmane quhej Mahmud Bejzade [*zade*, në persisht ‘bir fisniku’], ... që më vonë zëvendësohet me Mahmutbejoli, e më vonë me Mahmudbegolli” (Begolli, 2015).

Është interesant të përmendim se kemi hasur familje me mbiemër *Begolli* që nuk lidhet me ndonjë ‘beg’, por me emrin e një të pari të tyre. Një familje e tillë është familja e Abdullah Begollit, nga fshati Kaqanoll i Shalës së Bajgores të Mitrovicës, e cila mbiemrin Begolli e kanë nga një paraardhës i tyre me emrin Beg (si duket i pari i konvertuar në fenë islame), i biri i Maletës (katolik). Kushërinjtë e Abdullahut nga Vllahia e Shalës së Bajgores e mbajnë mbiemrin Begu [Abdullah Begolli].

- Mbiemrat me **Haxhi-** (titull fetar):

Haxhibeqiri, Haxhidema, Haxhihamza, Haxhiimeri, Haxhiislami, Haxhijaha, Haxhijahja, Haxhijusufi, Haxhikadrija, Haxhimusaj, Haxhimusliqi, Haxhimustafa, Haxhisalihu, Haxhia, Haxhiaj, Haxhiajdini, Haxhialiu, Haxhiasani, Haxhiasdini, Haxhiavdija, Haxhiavdyli, Haxhiavojli, Haxhibajrami, Haxhibeqiri, Haxhibeqiri, Haxhibeti, Haxhibrahimi, Haxhidaui, Haxhidema, Haxhimustafa, Haxhifazliu, Haxhifejzullahu, Haxhigjemajli, Haxhihajdini, Haxhihamza, Haxhihasani, Haxhiimeri, Haxhiislami; Haxhija, Haxhijaj, Haxhiju; Haxhijaha, Haxhijahja, Haxhijakupi, Haxhijanuzi, Haxhijolli, Haxhijonuzi, Haxhijsmajli, Haxhikadria, Haxhikadrija, Haxhikadriu, Haxhikurteshi, Haxhilari, Haxhilatifti, Haxhimagjuni, Haxhimaxhuni, Haxhimehmedi, Haxhimehmeti, Haxhimeri, Haxhimiftari, Haxhimurati, Haxhimusa, Haxhimusliqi, Haxhimustafa, Haxhimustapa, Haxhimyftari, Haxhinikaj, Haxhiolli, Haxhisefa, Haxhisefaj, Haxhiselimaj, Haxhismajli, Haxhishabani, Haxhitasimi, Haxhiu, Haxhiveseli, Haxhixhemajli, Haxhixhemajli, Haxhiymeri.

- Mbiemrat me **Mulla-** (titull fetar):

Mullaabazi, Mullaademi, Mullaaliu, Mullaavda, Mullabazi, Mullafazliu, Mullafeta, Mullafetahu, Mullahasani, Mullahaxhia, Mullaibrahimi, Mullajupi, Mullakadria, Mullakadrija, Mullalija, Mullaliu, Mullamisini, Mullarama, Mullatahiri, Mullavda, Mullaxhela/Mullagjela, Mullazenuni.

- Në këtë kategori hyjnë edhe këta mbiemra të vjetër:

Bardhi (531)/Bardheci (176) /Bardhaj (124)/Bardhecaj (44)/Bardhoku (24)/ Bardhoshi (25), Deda/Dedaj (579/625), Gjergjaj (336), Gjergji (253), Gjinaj (135), Gjini (502), Gjinnolli (75), Leka (643), Lekaj (1057), Lekiqi (171), Leku (287), Lika (883), Likaj (582), Lleshaj (313), Lleshi (488), Lluca (164), Llukaj (35), Markaj (619), Marki (125), Marku (650), Mataj (481), Mazreku (2505), Ndrecaj (320), Nikaj (214), Pjetraj (134), Pjetri (204), Prekaj (229), Prenaj (393), Uka/Ukaj (3492/1971).

Shembull i trungut familjar të një familjeje Deda nga Prishtina, me origjinë nga Gjakova: Shpati – Fatoni – Xheladini – Shukriu – Murati – Tahiri – Marku – Deda. [Shpat Deda, 31 vjeç nga Prishtina].

Sipas Ismet Bardhoshit, i fisit Gash, nga Gjakova, mbiemrin *Bardhoshi* e kanë sipas katragjyshit të tyre Bardhosh Hysenit, nga fshati Begaj i Malësisë së Gjakovës, i cili humbi jetën në përballje me malazezët diku kah mesi i shekullit XIX. Ja dhe trangu i kësaj familjeje: Ismet – Haxhi – Avdyl – Sali – **Bardhosh** – Hysen – Islam – Dëshë – Tafë – Memi – Bardh. Po sipas Ismetit, prej këtij Memi Bardhit kanë qenë 300 shtëpi Gash në Malësi, rreth një shekulli më herët. Disa fshatra dhe janë quajtur ‘gashjanë bardhjanë’ ose ‘bardhas’.

Një mbiemër mjaft i vjetër është edhe mbiemri *Drançolli*. Sipas historianit Jahja Drançollit (65 vjeç, nga Peja/Prishtina), mbiemri Drançolli paraqitet në dokumente mesjetare në trajtën, *Dranço* (në Krisobulën e Deçanit, 1330); *Drançi* (në Kadastrin venedikas të Shkodrës, 1416/17); *Drançis* (në një dokument të zyrës së Dubrovnikut, 1496), etj. Dokumentet në fjalë përputhen edhe me historinë gojore të ruajtur edhe nga vëllazëria e sotme Drançolli, vëllazëri kjo që gjatë mesjetës ka qenë e shtrirë në Pejë, Novobërdë dhe Shkodër (sipas tyre paskan qenë tre vëllezër). Në mbështetje të historisë gojore (traditës) familjare, preferohet se origjina e mbiemrit ndërlidhet me emrin e drangonit. Në mesin e pjesëtarëve të vëllazërisë në fjalë (Pal Drançi) nga kapërcyelli i shek. XVII ka qenë ipeshkëv i Shkodrës. Prapashtesa *-olli* paraqitet në shek. XVIII e më tej.

Si patronim zakonisht merret emri i ndonjë të pari të njohur. Kështu, siç tregon Idriz Çelaj (65 vjeç), nga Lutogllava (Arbana) e Pejës, me banim tash në Nju Jork të SHBA-së, mbiemri Çelaj u ka mbetur sipas Çel Shabanit, dëshmor i kombit, zv. komandant në Luftën e Nokshiqit (janar 1880). Sipas tij, familja më herët është thirrur Kelmendi, pastaj Lajqi, por babai i Idrizit, Binak Zhuka, edhe ai vetë luftëtar, e ka pa të arsyeshme që mbiemrin ta kthejnë sipas të madhit Çel Shabani. Trangu familjar i kësaj familjeje me origjinë nga fshati Stankaj i Rugovës është ky: Ardriti – Idrizi – Binaku – Zhuka – Haxhia – **Çela** – **Shabani** – Nika – Deda dhe Prelë Rugova.

Nga një tjetër ‘Çelë Shabani’ e nxjerr prejardhjen e vet edhe familja, po ashtu kelmendase, e nënfisit Nikç, me origjinë nga Vuthaj e Malësisë, e Lirak Çelës (43 vjeç, nga Prishtina): Liraku – Zenuni – Halili – Ethemi – Kasemi – Musliu – **Çela** – **Shabani** – Ula – Nika – Nreu – Bala dhe Engjoni (?).

Ish pleqnari i Malësisë Shaban Binaku e ka pasur një djalë me emrin Çelë, kështu nuk janë të rralla rastet në Malësi kur Shabani ia ka

ngjitur djalit të vet emrin Çelë (një rast të tillë e kemi, p.sh. te Çelë Shaban Lamaj, me origjinë nga Tropoja).

Emri Çelë, edhe pse i rrallë, ende gjallon edhe në Kosovë, p.sh. Çelë Sheqir Gashi (1966), nga Dobërdoli i Podujevës, këtë emër e ka trashëguar nga gjyshi i vet Çela, i zhdukur pas Luftës së Dytë Botërore, më 1946 në ish-Jugosllavi. Ai emrin e vet e shpjegon si: ‘i çiltër’, ‘i hapur’.

Një mbiemër po ashtu i vjetër, të cilin e bart një familje e gjerë, e ardhur në Kosovë nga Vuthajt e Malësisë së Madhe, është mbiemri *Dedushaj*. Sipas Isuf Dedushajt (65 vjeç nga Vuthaj/Prishtina), kelmendas, i biri i Isufit (i pushkatuar në vitin 1951, 4 muaj para se të lind ky), e i ati i tij i biri i Zymer Tahir Sylë Hasan Isuf Dedës, këtë mbiemër e kanë nga paraardhësi i tyre Deda i Ndre Balës, i cili ka jetuar pas vitit 1700 dhe ka qenë prijës kundër ushtrisë otomane. Deda ka qenë vëllai më i madh i pesë nipave të Gjon Balës, nga rrjedhin familja e madhe Gjonbalaj e Vuthajve që sot jetojnë gjithandej trojeve etnike dhe SHBA. Sipas gojëdhënës fshati Vuthaj është krijuar nga Vuth Nisha [Isuf Dedushaj].

Është interesant edhe mbiemri Mekaj i një familjeje nga fshati Stankaj i Rugovës, e barkut të Lajçit, nga fisi Kelmend, në bazë të një të pari të tyre me emrin *Mek*. Ja trangu i kësaj familjeje: Kamberi – Osmani – Aliu – Rexha – Meku [Kamber Mekaj].

- Në Kosovë është karakteristike për gratë e martuara edhe dukuria e shtimit të mbiemrit të burrit mbiemrit të vajzërisë. Kombinimi i mbiemrave të tillë është nga më të ndryshmit, si: Arbona *Bajçinovci-Hyseni*, Aferdita *Bajgora-Berisha*, Edita *Bajraktari-Stavileci*, Gentiana *Begolli-Pustina*, Shkurte *Berisha-Kastrati*, Sherife *Berisha-Thaqi*, Vjollca *Belegu-Caka*, Nurten *Beligradi-Deva*, Donika *Dabishevci-Jetullahu*, Blerta *Deliu-Kodra*, Miranda *Dobroshi-Axhanela*, Arianisa *Doko-Gjerqeku*, Visare *Duraku-Dragusha*, Shkëndije *Geci-Sherifi*, Elmas *Govori-Sekiraqa*, Mjellma *Gjergjizi-Muzbegu*, Sara *Habipaj-Polloshka*, Drita *Hakaj-Hadergjonaj*, Dafina *Hajredinaj-Brahaj*, Albana *Hajrizi-Kunishevci*, Dhurata *Hoxha-Thaçi*, Sevdije *Huruglica-Hasangjekaj*, Ajeta *Iljazi-Begolli*, Shqipe *Ibraj-Mala*, Donika *Kadaj-Bujupi*, Margarita *Kadriu-Ukelli*, Sabile *Keçmezi-Basha*, Jeta *Kasapolli-Qarolli*, Resmije *Kastrati-Morina*, Lumturie *Kollçaku-Bytyqi*, Valbona *Kuçi-Shala*, Vehibe *Kuksi-Karahoda*, Mimoza **Kusari-Lila**, Sahadete *Llalloshi-Sllamniku*, Aida *Obërtinca-Kosumi*,

Shpresa Opoja-Shkodra, Blerina Pagarusha-Bajraj, Emine Petrovci-Dervishaj, Pranvera Pushka-Pashoja, Valdete Rexhëbeqaj-Hamiti, Fitore Sylejmani-Kryeziu, Elvane Shala-Tola, Dorentina Shehu-Berisha, Shpresa Shehu-Kursani, Lume Shkodra-Hasani, Vlora Tërnavë-Zhjeqi, **Valdete Zenuni-Lajqi**, Zana Zherka-Bunjaku etj.

Mbiemrat e këtij tipi, zakonisht, nuk trashëgohen në pasardhës dhe ata rëndom janë unikë, ndonëse mund të hasen edhe dy e më shumë raste të kombinimit të njëjtë.

2.2 Mbiemrat topografikë

Nuk janë të paktë as mbiemrat që tregojnë se prej nga kanë ardhur a supozohet se kanë ardhur të parët e bartësve të këtyre mbiemrave. Te shqiptarët kemi të bëjmë kryesisht me shpërnguljen e popullatës nga fshati në qytet, apo nga një qytet në tjetrin, përbrenda Kosovës, por dhe nga Shqipëria dhe trevat e banuara me shqiptarë në Maqedoni, Mal të Zi e Serbi.

- Sipas krahinës a trevës prej nga mendohet se e kanë prejardhjen të parët e bartësve të mbiemrit, kemi këta mbiemra:

Drenica, Dukagjini, Gora, Hasi, Kosova, Kraja, Llapi, Mati, Mirdita, Opoja, Podrimaj, Tropoja etj.;

- Sipas qytetit prej nga mendohet se e kanë prejardhjen të parët e bartësve të mbiemrit, kemi këta mbiemra:

Dibra, Dragashi, Ferizaj, Gostivari, Gjakova, Gjilani, Janjeva, Kaçaniku, Kamenica, Kavaja, Korça, Kuksi, Mitrovica, Novobërda, Peja, Podujeva, Presheva, Prishtina, Prizreni, Puka, Rahoveci, Shkodra, Shkupi, Tetova, Tirana, Vuçitërna, Zhuri etj.;

- Sipas fshatit (katundit) prej nga mendohet se e kanë prejardhjen të parët e bartësve të mbiemrit, kemi këta mbiemra:

– Nga fshatrat e Gjakovës dhe nga vetë Gjakova:

Batusha, Beci, Brovina, Cërmjani, Damjani, Deva, Dobroshi, Doli, Dujaka, Firza, Gjakova, Godeni, Krelani, Kusari, Lipoveci, Molliqi, Nivokazi, Oseku, Pacaj, Ponosheci, Qerimi (po e dhe nga emri Qerim), Radoniqi, Rakoci, Rogova, Rracaj,

Skivjani, Smaqi, Smolica, Stublla (po dhe të trevave të tjera),
Sheremeti, Trakaniqi, Vraniqi, Zhabeli, Zhdrella, Zhubi.

Mbiemra me prejardhje nga fshatrat e Gjakovës kemi gjithandej Kosovës, meqë gjakovarët si tregtarë, janë përhapur në tërë Kosovën por dhe më gjerë, në Shqipëri, Maqedoni, Bosnje etj.

Kështu, p.sh. familja Dobruna e ka origjinën nga fshati Dobrunë i Malësisë së Gjakovës, prej nga para 300 vjetëve janë vendosur në Gjakovë. Pastaj, një grup tjetër nga aty ka shkuar ne Deçan. Thuhet se këto familje e kanë themeluar qytetin e Deçanit. Ata në Deçan ia kanë shtuar një "j" mbiemrit në fund, pra Dobrunaj. Një pjesë tjetër nga Gjakova ka shkuar drejt Pejës, Prizrenit, Suharekës (këta më vonë e kanë marrë mbiemrin Balaj – i ndjeri avokati Fazli Balaj është pasardhës i tyre), Drenicës dhe Prishtinës [Kujtim Dobruna].

– Nga fshatrat e Mitrovicës dhe nga vetë Mitrovica:

Bajgora, Broboniqi, Kaçandolli, Koshtova/Koshutova, Kutllovci, Lisica, Lushta, Magjera, Mazhiqi, Mitrovica, Pirqi, Rahova, Rashani, Selaci, Suhodolli, Shipoli, Tërstena, Vidishiqi, Zabërxha, Zasella, Zhabari

– Nga fshatrat e Pejës dhe nga vetë Peja:

Babiqi, Berani, Bogiqi, Buçaj, Çallapeku, Dobërdoli, Dubova, Glllogjani, Grabovci, Haxhaj, Kuqishta, Lipaj, Loxha, Loxhaj, Lubeniqi, Llabjani, Llozhani, Novosella, Peja, Pepiqi, Pishtani, Rashiqi, Sverka, Shkreli, Turjaka, Vranoci.

– Nga fshatrat e Podujevës dhe nga vetë Podujeva:

Bajçinca (?), Bellopoja, Bërveniku, Bllata, Breca, Dobërdoli, Dumnica, Dumoshi, Halabaku, Hërtica, Kushevica, Lupçi, Llapashtica, Llausha (edhe fshat në rrethin e Skenderajt), *Majaci, Merdari, Miroci, Pakashtica, Podujeva, Popova, Potoku, Reçica, Revuqi, Surdulli, Surkishi, Sylevica, Tërnavë, Zakuti, Zhitia.*

– Nga fshatrat e Prishtinës dhe nga vetë Prishtina:

Ballabani, Barileva, Koliqi, Kolovica, Marevci, Nishevc, Prapashtica, Prishtina, Rimanishta, Tenezhdolli.

– Nga fshatrat e Prizrenit dhe nga vetë Prizreni:

Gjonaj, Jabllanica, Kabashi, Krajku, Krusha, Kushnini, Lubiqeva, Llokvica, Mamusha, Mazreku, Milaj, Novosella, Petrova, Pirana, Prizreni, Randobrava, Reçani, Smaçi, Struzha, Shkoza, Shpenadija, Tupeci, Vërmica, Zymi, Zhuri.

- Nga fshatrat e Skenderajt dhe nga vetë Skenderaj:
Abrija, Buroja, Çitaku, Çubreli, Dashevc, Kopiliqi, Kosterci, Kotorri, Likovci, Lubaveci, Llausha, Mikushnica, Plluzhina, Polaci, Prekazi, Skenderaj (mund të mos kenë lidhje me qytetin Skenderaj), *Vitaku*.
- Kemi edhe ndonjë mbiemër të rrallë si *Beligradi*, i cili sipas dëshmisë së Nurten Beligradi-Deva (e bija e Ibrahim Salim Hysein Salimit) është marrë sipas gjyshit të saj, Hyseini i cili ka lindur në Beograd (Beligrad). Kështu, nga mbiemri Hyseni kanë kaluar në Beligradi.
- Interessant është edhe tregimi për prejardhjen e mbiemrit *Karaqi* (Karaçi) të një familjeje me origjinë nga rrethi i Gjakovës. Sipas Mikel Karaqit (nga Prishtina, tash me vendbanim në Pragë të Çekisë), njëri version është: Në kohën e sundimit osman një paraardhës i tyre ka shërbyer si ushtar në kryeqytetin e Pakistanit - Karaçi dhe i mahnitur me bukurinë e tij, kur është kthyer në shtëpi u ka thënë të gjithëve se tash e tutje në vend të Majoshi do të quheshin Karaqi. Plaku që ia ka thënë këtë tregim ka qenë bujk (dhe Mikeli nuk beson që ka pasur njohuri që kryeqyteti i atëhershëm i Pakistanit e ka pasur emrin Karaqi). Sipas versionit të dytë: Familja e tyre Majoshi nga fshati Bisak në Mirditë, shtëpinë e ka pasur rrëzë mali që ata i kanë thënë “karaja” dhe pas një kohe si identifikim – prej shtëpisë së Majoshve te karaja e kanë ndërruar në “te Karaqt”. Kjo vetëm tregon se gjetja e prejardhjes së një mbiemri nuk është gjithmonë punë e lehtë.

Disa mbiemra tregojnë banorin prej nga ka ardhur i pari i bartësit të mbiemrit të tillë:

Dibrani (nga Dibra), *Janjevaliu* (nga Janjeva), *Novobërdaliu* (nga Novobërda), *Podrimçaku* (nga Podrimja), *Shkodrani* (nga Shkodra), *Ulqinaku* (nga Ulqini);

Malsori, Malësori, Malesori; Malokaj, Maloku, Malsia, Malsija, Malsiu, Malsoraj.

Kështu, p.sh. mbiemri *Dibra* (165) i disa familjeve në Kosovë ka të bëjë me origjinën e tyre nga Dibra e Madhe, e të shpërngulur së pari në Gjakovë diku rreth shekullit XVII (Bedri Dibra, 63 vjeç nga Prishtina, tash me vendbanim në Bruksel të Belgjikës). Po me Dibrën ka lidhje edhe mbiemri *Dibrani* (952).

Kur kemi të bëjmë me mbiemrat sipas qytetit të prejardhjes, të përmendim këtu një rast karakteristik. Sipas Fadil Preshevës (nga Presheva/Prishtina, tash me vendbanim në Nju Jork, SHBA), i quajtur më parë Fadil Selimi, mbiemri *Presheva* (25) i ka mbetur prej kohës së themelimit të programit televiziv në gjuhën shqipe "Pasqyra televizive" më 1966. Për të treguar se në këtë program televiziv nuk punojnë vetëm shqiptarët e Kosovës, por se aty ka edhe prej vendeve të tjera, bashkëpunëtorët ia kanë vënë nofkën (llagapin) *Presheva*, sipas vendlindjes së tij, të cilin ky më vonë e ka pranuar si mbiemër.

- Këtu përfshihen edhe mbiemrat e muhaxhirëve nga Sanxhaku i Nishit, të dëbuar nga trojet e veta më 1878 kur këto vise i takuan Serbisë (Uka, 2004):

Babatinca, Baca, Bajçinca, Bajçinovci, Bajra, Bellopoja, Bërbatovci, Berila, Bllaca, Bogujevci, Bogunovci, Bojniku, Borinca, Borinci, Borovci, Braina, Brajshori, Brestovci, Breznica, Bublica, Buci, Buçinca, Budeci, Byçmeti, Cërvadiku, Çukovci, Dabinovci, Dedinca, Dobrlluka, Dragobuzhda, Dragusha, Drevina, Dubova, Dumnica, Dushullovc, Gajtani, Gërguri, Gërxhaliu, Grainca, Gubetini, Gjaka, Gjemnica, Gjigoli, Gjushinca, Hasanovci, Huruglica, Igrishta, Ivaja, Jashanica, Kapiti, Kastrati, Kërtoku, Klaiqi, Kodra, Kojçiqi, Kolludra, Konjuhi, Konjusha, Konjuvci, Konxheli, Kostanica, Kozmaqi, Kuçi, Kutllovci, Lepaja, Lushaku, Llapatinca, Llozana, Llumnica, Magashi, Magjera, Maqedonci, Maqestena, Masurica, Matarova, Megjuani, Mehana, Mërkoja, Mërlaku, Merofci, Mijalica, Mikulani, Muzaqi, Novosella, Obërtinca, Orana, Ostërgllava, Paçarada, Përvetica, Petrovci, Piskala, Pllana, Pllashniku, Podvorica, Pollomi, Prebreza, Prekadini, Prekopuca, Prestreshi, Qyqalla, Raça, Rafuna, Rakovica, Rashica, Ratkoceri, Restelica, Rudari, Rukofci, Sfarqa, Sfirca, Simnica, Slishani, Sllamniku, Spanca, Statovci, Stublla, Stullca, Surdulli, Svarça, Shahiqi, Shillova, Shulemaja, Termkolli, Tërnavë, Tërstena, Tmava, Topanica, Tovërlani, Tovorlani, Tullari, Turjani, Vërshevc, Visoka, Vishesella, Vllahinja, Vllasa, Vujanova, Xhaka, Zagragja, Zebica, Zhegrova, Zhinipotoku, Zhushi.

Për shembull, prejardhja e mbiemrit *Dragidella* është nga emri i fshatit Dragi Deo në bjeshkën Radan në afërsi të Prokuplës në Serbinë e sotme, prej nga janë dëbuar më 1878 paraardhësit e Dragidellëve që sot jetojnë në Kosovë e më gjerë [Lulzim Dragidella]. Sipas të

dhënave serbe nga Interneti, “në këtë fshat janë shpërngulur dhjetëra shtëpi pas luftës serbo-turke më 1878 nga Vlasina”. Ai sot ka shumë pak banorë. Për dhjetë vjet në të nuk ka lindur asnjë fëmijë i kombësisë serbe, ndërkohë që nga katër romë janë bërë dhjetë. Kjo sa për të ilustruar fatin e disa ish-vendbanimeve shqiptare në këto anë (<http://www.pustareka.org.rs/naselja.htm>)

Vërejtje: Duhet cekur këtu se jo të gjithë ‘muhaxhirët’ mbajnë si mbiemër emrin e vendit prej nga kanë ardhur. Shumë prej tyre si mbiemër (emër familjar) mbajnë emrin e ndonjë të pari të tyre. Kështu p.sh. familja e Asllan Emin Bajramit (61 vjeç nga Prapashtica e Prishtinës), e fisit Krasniq, mbiemrin Bajrami e mban që nga viti 1921 për respekt të gjyshit të tyre, i cili me shumë sakrifica ka arritur të shpëtojë familjen e tij në vitin 1879, kur është shpërngulur me dhunë nga pushtuesit serbë nga Toplica, rrethinat e Krushevcit (Krushevac), Serbia e sotme.

Kemi fshatra me emër të njëjtë në rajone të ndryshme të Kosovës, disa prej të cilave përputhen me emrat e fshatrave të Sanxhakut të Nishit prej nga janë ngulitur shqiptarët që si muhaxhirë kanë ardhur atje pas dëbimit prej vatrave të tyre më 1878, si p.sh. Raça në rrethin e Gjakovës, po dhe në Toplicë (Serbi).

Nga trangu familjar i familjes gjakovare *Ermeni*, të ardhur në Gjakovë nga fshati Ermen i Shqipërisë së mesme pas viti 1700 shihet harku kohor që kapin 7 breza: Vlerori (2004) – Bekimi (1967) – Qemajli (1942) – Aliu (1901) – Sylejmani (1865) – Haxhihoxha (1830) – Lomi (1795) [sipas Bekim Ermenit, 49 vjeç, nga Gjakova].

- Në këtë grup bëjnë pjesë edhe mbiemrat sipas fisit a bajrakut:
Berisha, Bytyçi/Bytyqi, Gashi, Gruda, Hoti, Kabashi, Kastrati, Kelmendi, Krasniqi, Kuqi/Kuçi, Kryeziu, Morina, Sopi, Shala, Thaçi/Thaqi.

Në Kosovë është ruajtur tradita e përkatësisë së një fisi të caktuar, por jo me rigorozitetin e Mesjetës, kur me *fis* nënkuptohej ‘një bashkësi njerëzish me gjuhë e zakone të përbashkëta, me një prijës në krye, që vetëqeveriseshin sipas së drejtës zakonore (FGjSh, 2006), por as të para një shekulli, kështu që sot për familjen e dhëndrit nuk paraqet pengesë për martesë nëse edhe nusja është e të njëjtit fis.

Te shqiptarët ekziston tradita e dymbëdhjetë fiseve kryesore. Ahmet Maloku (*Përparimi*, 1963, nr. 1-2, f. 94-97) thotë se “Simbas fjalëve të pleqve të rrethit të Gjakovës, në këto anë kemi këto fise: Hoti, Shala, Gashi, Krasniqi, Kastrati, Berisha, Kelmendi, Morina, Thaçi, Shoshi,

Nikajt dhe Bytyçi". Ai vetë, ndërkaq, thotë se ekzistojnë gjithsej shtatë fise: Shala, Berisha, Thaçi, Hoti, Kelmendi, Gashi dhe Krasniqi. Edhe njëri variant, edhe varianti tjetër lidhen me numrat 'magjikë' 'dymbëdhjetë' (dymbëdhjetë muajt e vitit, dymbëdhjetë apostujt etj.), përkatësisht 'shtatë' (shtatë ditët e javës, shtatë kralat, shtatë zanat etj.).

Fiset ndahen në nënfise, vëllazëri, barqe e familje, p.sh. fisi Kelmend – nënfisi Nikç.

- Të formuar sipas ndonjë nocioni nga gjeografia kemi mbiemrat:

Fusha, Kodra, Lugu, Shkambi, Pylla, Rekathati, Trolli, Zabeli.

Mbiemri *Fusha* (88) – Sipas Bajram Fushës, nga Podujeva, mbiemri Fusha u ka mbetur në fillim të shekullit '20, në bazë të jetës së tyre dhe shtëpive që i kishin në rrafsh (fushë) të Llapit në Podujevë. Familja Fusha ishte familja e vetme e cila ka jetuar në rrafsh të Llapit, Podujevës, ku kanë pasur një sipërfaqe toke rreth 80 hektarë. Shtëpia e lindjes e babagjyshit edhe e babës së tij ishte në vendin ku sot është shkolla e mesme. Duke pasur parasysh se Podujeva është e rrafshët dhe kishte gjithandej fusha, edhe familja e tyre mori emrin në bazë të jetës së tyre dhe shtëpive që i kishin në fusha: Fusha – Fushali.

Mbiemri *Pylla* (27) – sipas Hysen Pyllës, i fisit Thaç, nga Gjakova, përkatësisht xhaxhait të tij Ahmet Pylla, që ka jetuar dhe ka vdekur në Tiranë, ky mbiemër u ka mbetur nga ajo që në shtëpinë e tyre të vjetër mbi 350-vjeçare në lagjen Gece të Gjakovës ka qenë një fushë (oborr) shumë e madhe me pemë – drunj, dhe kjo ka bërë që kur i kanë pyetur kalimtarët "nga kaluat?", shumica janë përgjigjur "nga ajo fusha me pemë (pylli)". Pastaj kjo me kohë është ndryshuar (modifikuar) në 'pylla' dhe kështu u ka mbetur mbiemri Pylla.

Mbiemri *Zabeli* (365) – Sipas Muharrem Zabelit, nga Rrezalla e Skenderajt, ky mbiemër u ka mbetur se lagjja e tyre në këtë fshat gjendet rrëzë (afër) malit (*zabelit*), dhe paraardhësit e tyre kanë pasur sipërfaqe goxha të madhe të malit, që edhe sot këta e trashëgojnë.

Mbiemri *Lumi* (416) – Sipas Alban Lumit, ky mbiemër u ka mbetur pasi që të parët e tyre e kanë pasur shtëpinë afër një lumi në fshatin Bllacë të Suharekës, dhe e gjithë lagjja e ka marrë atë mbiemër. Kjo ka ngjarë pas Luftës së Dytë Botërore. Trungu i kësaj familjeje: Albani – Isufi – Sherifi – Ramadani – Selmani – Syla – Selimi – Syla – Imeri.

2.3. Mbiemrat sipas profesionit a gradës

Mbiemrat që tregojnë zanate dhe profesione ose tituj fetarë e zyrtarë, a grada ushtarake janë të larmishëm:

2.3.1 Mbiemrat me **-xhiu (xhija)/gjiu**, që tregojnë kryesisht zanate (por dhe që mund të mos kenë të bëjnë me zanate):

Arzoallxhi; Bojagji, Bojaxhi, Bojaxhiu; Bozaxhiu; Çakërgji, Çakrgji; Çarkaxhiu; Çeshmegjiu, Çeshmexhiu; Çestenegji; Çjergji; Çulangji, Çulanxhi, Çylangji, Çylanxhi, Çyljangji; Daulgji, Daullgji, Daullxhi; Degërmengji; Dervagji, Dervaxhi, Dervargji; Devexhiu; Eçegji, Egegji, Egexhi; Fishekrgji; Gjebexhi; Gjeregji; Gjibexhi, Gjibixhi; Gjingji; Gjurgji; Hargji, Harxhi; Iggji, Igxhi; Jagxhi, Jagxhiu; Jorgangji, Jorganxhi; Kafexhiu, Kallajxhi, Kantargji, Kantarxhi; Karagji, Karaxhi, Kengji, Kenxhi; Kingji, Kovangji, Kovanxhi; Limanagji, Limanaxhi, Limonaxhiu; Matranxhi, Mexhixhi, Mumxhiu, Nallëngji, Nallënxhi; Namlegji, Namlexhi; Pangji, Panxhi; Qarkaxhiu, Qarkaxhija; Qeshmexhi; Qiraxhiu; Qulangji, Quljangji, Qylangji; Sahagji; Shakagji, Shekagji, Shekaxhi; Shekerxhi, Sheqergji; Shigjegji, Shixhexhi; Takijaxhi, Tatlixhi, Topxhi; Tyfekrgji, Vagagji, Vagaxhi; Vagangji; Xhergji, Xherxhi; Xhibexhi, Xhibixhi; Xhingji; Zurnagji, Zurnaxhi.

Mbiemri *Bojaxhiu* – Sipas Dardane Gazmend Bojaxhiut, përkatësisht babait të saj Gazmendit, nga Prizreni, mbiemri Bojaxhi iu paska mbetur pasi që janë marrë me tregtinë e ngjyrave (bojave). Sipas tyre prejardhja e të gjithë Bojaxhinjve kudo që janë, edhe e atyre në Shkup, edhe e atyre në Shqipëri e gjetiu, është nga Prizreni. Me ardhjen e sundimit osman, ata që nuk kanë pranuar të konvertohen në myslimanë janë shpërngulur në Shkup (familja e Nënës Tereze) e disa të tjerë në Shqipëri (në Berat, p.sh.) e familja që tash është në Prizren janë shpërngulur në malet e Sharrit, në Trokan dhe sipas gojëdhënës e kanë formuar fshatin Pllave.

Mbiemri *Sahatçiu* (orëtar, orëndreqës) – Sipas Kastriot (Ismajl Jahja Selim Mehmet) Sahatçiu, 37 vjeç, nga Prishtina, këtë mbiemër e kanë që nga katragjyshi i tyre Mehmet Sahatçiu, i cili e ka marrë këtë mbiemër sipas zanatit që ka ushtruar - sahatçi (orëndreqës). Origjina e familjes Sahatçiu ka më shumë se 150 vite. Sipas tij, familja e tyre vjen nga fisi Krasniqe nga Malësia e Shkodrës, prej nga pastaj kanë ardhur në Gjakovë ku janë quajtur Kazazi, sipas zejës që kanë ushtruar atëherë (*kazaz*, turq. zejtar, që në kohën e Turqisë merrej

me tjerren dhe pejzimin e mëndafshit dhe punimin e gajtanëve etj., Dizdari 2005), e më pas e kanë marrë mbiemrin Sahatçiu. Pra *Kazazët* e Gjakovës janë kushërinj me *Sahatçinjt* [Lulzim Kazazi]. Babai i Kastriotit, Ismajli ka punuar si sahatçi deri në vitin e kaluar para se të vdesë. Fëmijët e Ismajlit e dinë zanatin e sahatçiu, por tash për tash nuk e punojnë. Por ka të tjerë nga familja e gjerë, si p.sh. Valdet (Xhavit Adem Mehmet) Sahatçiu nga Prishtina vëllezërit Valon e Visar (Muhamet Adem Mehmet) Sahatçiu në Pejë. I kësaj familjeje është edhe babai i Rita Orës, Besnik (Besim Adem Mehmet) Sahatçiu.

2.3.2 Mbiemrat me *-çiu/qiu*, që tregojnë po ashtu zanate:

Burnutçiu, Çibukçiu, Çibukqiu; Çiburçiu, Fishekçiu, Fishekqiu; Gibukçiu; Hapçiu, Hapqiu; Ibqiu, Ipçiu, Ipqiu; Kaçiu; Kajmakqiu, Makasçiu, Makasqiu; Qibukqiu, Safçiu, Safqiu; Sahatçiu, Sahatqiu; Sapatçiu, Saraçi, Saraqi; Simitçiu, Simitqiu; Tafçiu; Telqiu; Topçiu; Tyfekçiu, Tyfekqiu.

Zanat tregon edhe mbiemri *Terziu* (rrobaqepës). Sipas Shpend Terziut nga Gjilani, i cili e çon historinë e familjes së vet deri në vitin 1716, kur ajo për herë të parë shfaqet në Gjakovë, çuditërisht askush nga anëtarët e familjeve Terziu në Kosovë, po dhe në Shqipëri e Maqedoni, nuk e ushtrojnë sot zanatin/mjeshtërinë e terziut (rrobaqepësit), edhe pse ky zanat është ende ‘gjallë’ dhe i kërkuar.

Edhe mbiemri *Tabaku* (209) tregon se të parët e atyre që bartin këtë mbiemër kanë qenë zanatli a zejtarë, pikërisht lëkurëregjës a ‘tabakë’ (nga turq. *tabak*, e kjo nga ar. *debbag*).

Në Mesjetë, zejtarët e profesionit të njëjtë, po dhe tregtarët që tregtonin të njëjtin mall, bashkoheshin në shoqata a lidhje të zejtarëve, përkatësisht të tregtarëve, të njohura si *esnafe* (turq. *esnaf*, nga ar. *esnaf* < *sinf* ‘klasë’). Në Kosovë, pikërisht në Gjakovë, në kohën e Perandorisë osmane kanë qenë të njohura esnafi i tabakëve dhe esnafi i terzive. Këto esnafa në shek. XVIII në këtë qytet i kanë ndërtuar urat e njohura, tash objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore: Urën e Terzive, me një gjatësi prej 192 metra dhe 11 harqe dhe - Urën e Tabakëve, me një gjatësi prej 127 metra (MKRS: Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës).

Një zanat tjetër tashmë i zhdukur në Kosovë është edhe zanati i qiripunuesve a mumxhive, prej nga rrjedh mbiemri *Mumxhiu* (37).

2.3.3 Mbiemrat të formuar sipas profesionit:

Bakalli, Berberi, Kasapi, Kovaçi, Mjeku, Nallbani, Saraçi/Saraq, Tabaku, Terziu, Xhambazi.

Mbiemri *Mjeku* – Familja Mjeku, e cila jeton në fshatrat Graboc i Epërm dhe Shipitullë të komunës së Obiliqit, në këto dy fshatra është vendosur rreth vitit 1840. Ajo ka origjinën nga familja Gecaj nga Lluka e Poshtme e Deçanit. Paraardhësi i saj Mehmet Mjeku ishte mjek popullor dhe familja e mori "ngallëpin" nga profesioni i tij. Gjatë Jugosllavisë së Versajës, mbiemri Mjeku u ndryshua në Mjekiqi, dhe sot një pjesë e familjes e mban njërën mbiemër, e pjesa tjetër tjetrin [Bajram Mjeku].

2.3.4 Mbiemrat të formuar sipas titullit fetar:

Dervishi, Hoxha, Myderrizi, Shehu

Në Kosovë një mbiemër mjaft i shpeshtë është mbiemri *Hoxha* (6904), i cili rrjedh nga një i parë i familjes që ka qenë hoxhë. Kështu, sipas Murat Hoxhës, i fisit Thaç (Zogaj), nga fshati Bellanicë i Malishevës, në familjen e tyre kanë qenë shtatë breza hoxhë pas hoxhe, ose 'mullë', si i quan populli: mulla Imeri, (prapë) m. Imeri (rruga kryesore e fshatit Bellanicë e mban e emrin e tij), m. Avdullahu, m. Ibrahimimi (pjesëmarrës i Lidhjes së Prizrenit, 1878, i internuar në Turqi), m. Avdyli, m. Ibrahimimi dhe m. Rexhepi dhe tani që janë gjallë m. Imeri dhe m. Taulanti, kushërinj të Murat Hoxhës.

Nuk është i rrallë as mbiemri *Shehu* (2184), i cili haset në rajone të ndryshme.

Sipas Nexhmedin Shehut (70 vjeç), i fisit Thaç, nga Gjakova, mbiemrin *Shehu* e kanë nga stërgjyshi i tyre Haxhi Sheh Musaja, themelues i tarikatit Ryfai dhe i Teqesë së këtij tarikati, kah gjysma e Shekullit Nëntëmbëdhjetë.

Sipas Liridona Shehut (24 vjeç) nga Lukinaj e Prizrenit, mbiemrin *Shehu* e kanë nga viti 2000. Më parë janë quajtur Shehaj, e para kësaj me gjasë Krasniqi, sipas fisit. Në hilafetin (dekretin) me të cilin emërohet 'shehu' shkruan se shehu i parë Shejh Bekir Shehaj është veshur në 'sheh' në fillim të vitit 1924 dhe në vjeshtë të 1926-ës ka ndërruar jetë. Ajo që dihet deri tash është se Liridona është brezi i 15-të në familjen Shehaj, përkatësisht Shehu. Por ajo, e as të tjerët më të vjetër në Lukinaj të cilët i ka konsultuar ajo, nuk mund të shkojnë më shumë se 8-9 breza. Pra: Liridona, Velju, Zylfiu, Rexha, Alia, Sylja, Asllani, (I)Brahimi, Feta (Fetiu). Ka në familjen e tyre të gjerë

që ende e mbajnë mbiemrin Shehaj në dokumente, por shumica e kanë Shehu.

Sipas Shpresa Muhedin Shehu-Kursani nga Prishtina, mbiemrin *Shehu* e kanë nga gjyshi i tyre Shejh Mehmed Efendi Sezaiu (1874-1947), themelues i tarikatit dhe teqesë së Kaderive në Prishtinë, mbrojtës i të drejtave të shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave.

Në Kosovë ka mjaft njerëz me mbiemrin Dervishi (828)/ Dërvishi (88) e Dervisholli (393) / Dërvisholli (20), por si duket këta mbiemra nuk lidhen aq me 'dervishët' ('murgjit myslimanë'), por:

- me ndonjë të parë të tyre me emrin Dervish/Dërvish, emër ky jo edhe aq i rrallë (363) në Kosovë, p.sh. rapsodi i njohur popullor Dervish Shaqa (1912-1985), nga Lluka e Epërme e Deçanit, prof. Dervish Rozhaja (1934-1996), nga Peja ose prof. Dervish Qerreti (1953), të cilit, sipas tregimit të tij, ia kanë vënë emrin Dervish sepse ka lindur në shtëpinë e Dervish Begut, në Pejë); ose - me ndonjë të parë me tipare dervishi, 'njeri i mirë, bamirës' ose 'paralajmërues ndodhinash' (Dizdari, 2005).

Sipas Afërdita Dervishit nga Prishtina, mbiemri i tyre më parë ka qenë Balija, por gjyshi i saj Ibish Balija, nga fshati Gradicë i Drenasit, kur janë ndarë lagjet në fshat, ka vendosur ta marrë mbiemrin Dervishi, sipas emrit të kryeplakut, i cili është quajtur Dervish.

Sipas Ramadan Dervishit (39 vjeç), nga Prishtina, me origjinë po nga Gradica e Drenasit, mbiemri *Dervishi* u ka mbetur nga një i parë i tyre që është veshur dhe sjellë si 'dervish'.

Edhe këto dy raste tregojnë se ngandonjëherë nuk është lehtë të gjendet versioni më i besueshëm i shpjegimit të një mbiemri a 'emri familjar'.

2.3.5 Mbiemrat të formuar sipas titullit zyrtar:

Kadiu, Myftiu, Spahiu/Spahija.

Spahiu/Spahija (3211/730).– nga turq. *sipahi* (e kjo nga pers. *sepah*) 'ushtri, luftë' - feudal në Perandorinë Osmane, të cilit i jepej një pronë (timar) dhe e drejta për të vjelë detyrimet nga bujqit, me kusht që të shkonte në luftë si kalorës me një numër të caktuar ushtarësh. (Thomai, Jani etj. *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, ASHSh, Tiranë, 2006)

Sipas tregimit të Nexhmedin Spahiut (52 vjeç), nga Mitrovica mbiemri Spahiu u ka mbetur nga një i parë i tyre, me emrin Avdiu, i cili kishte marrë pjesë në luftën Ruso-Osmane më 1736, ku dekorohet

për trimëri nga Sulltan Mahmuti i Parë dhe merr titullin Spahi. Trungu i kësaj familjeje: Nexhmedini, Idrizi, Murati, Cena, Abdyli, Selmani, Fetahu, **Avdiu**, Ahmeti, Marku (nga fshati Bushat i Shkodrës i ardhur në Carabreg të Deçanit më 1700).

2.3.6 Mbiemrat të formuar sipas gradës ushtarake:

Bajraktari, Bimbashi, Bylykbashi, Çavdarbasha, Delibashzade.

Bajraktari/Bajraktaraj (3493/216) – nga turq. *bayraktar* (pers. *bāj-rāgdar*) ‘flamurtar’, titull dhe funksion i trashëgueshëm djalë mbas djali, brez mbas brezi, në organizimin fisnor të krahinave malore të Veriut. Bajraktari kryesonte parësinë e vendit dhe i printe fisit në kohë paqeje e në kohë lufte. Në kohën e Perandorisë Osmane, “në Kosovë turqit ua jepnin titullin e bajraktarit (flamurtarit) disa familjeve, zakonisht nëse dikush nga meshkujt e saj ishte dalluar në luftë me trimëri kundër armikut. Familje të tilla, familje bajraktarësh, në Kosovë ka pasur në numër të konsiderueshëm. Kjo ka mundësuar që, në rast nevojë, të mbledhesh një numër sa më i madh i ushtarëve, sepse, si parashihej edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, secila familje e bajrakut (flamurit) detyrohej që, kur të thirrej, të dilte në kuvend të flamurit ‘burrë për shpi’ dhe ‘të dilte në ushtri të flamurit’ (Krasniqi 1984). Sipas M. Mjekut (2008, f. 14), një paraardhës i familjes së sotme *Bajraktari* të Vranocit të Lugut të Baranit, titullin bajraktar e ka fituar nga pashai turk pas një dyluftimi me një harambash të taborëve kundërshtues (greke) me gjasë në Luftën e Moresë (1684). Më vonë, një Bajraktar i Vranocit, edhe pse e kishte marrë këtë titull për trimëri nga autoritetet turke, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, si pjesëmarrës i saj (1878), e kundërshton pushtimin osman dhe inkuadrohet në luftën për liri të trojeve shqiptare. (Mjeku, po aty, f. 15.). Edhe në Drenicë ka familje me mbiemrin Bajraktari. Ato kanë ardhur në Drenicë nga Carrabregu i Deçanit para 300 vjetësh dhe titullin bajraktar e kanë fituar në ndonjë nga betejat që turqit kanë zhvilluar në Ballkan. Siç tregon Gani Bajraktari, nga Prishtina, bajrakun (flamurin) një të tij ia ka dhënë, dhe nuk ia ka marrë më, bajraktari i deriatëhershëm që është sëmure gjatë betejës. Edhe stërgjyshi i tij ka qenë delegat i Lidhjes së Prizrenit (1878), përfaqësues i Drenicës, i pushkatuar tek Ura e Vushtrrisë si "pari e Drenicës" dhe i dekoruar nga shteti shqiptar si dëshmor i atdheut në 100-vjetorin e pavarësisë.

Me Perandorinë Osmane dhe me turqishten lidhen edhe mbiemrat (Dizdari 2005):

Bimbashi (124) – nga turq. *binbaşı* ‘kryemijës’ (bin ‘një mijë + başı ‘krye’), major, komandant i një batalioni.

Bylykbashi/Bylygbashi (480/142) – nga turq. *bölük basi*, ‘kreu i një njësie (ushtarake), i një kompanie etj., titull dhe funksion i kryetarit të një krahine.

Potera (374) – nga turq. *potere* ‘zhurmë, kërcëllimë, rrapëllimë, zallahi, zhaurimë; shamatë’, po dhe ‘thirrje, kushtrim, alarm’, “shenj dhe za me pushkë që jepet në Rumeli prej malit në mal, lajm mali; të ngritunit e popullit në gjithmbarësi për të luftue me anmik”.

Pra, me ‘kushtrim’ ka të bëjë mbiemri *Potera* i disa familjeve kosovare, i cili lidhet me luftën e Demë Ahmetit kundër serbëve që e kishin sulmuar Fshatin Reçicë (Mavriq) në vitin 1811. Ky vëlla i Havollëve (shih më poshtë!) lëshoi kushtrimin (‘poterën’) për t’i shkuar në ndihmë familjes së sulmuar. Rapsodi thotë: “Ngajshin Llap e ngajshin Shalë, kuajt e zi nga shkuma ishin ba të bardhë”. Nga kjo kohë, njëri prej vëllezërve të të parëve të fshatit Llapashticë mban mbiemrin *Potera* [Ymer Havolli].

Në Kosovë mjaft i shpeshtë është edhe mbiemri *Vojvoda* (400). Sipas Mark Krasniqit, “Rojtarët e kishave në Rrafshin e Dukagjinit e në Drenicë i quanin *vojvodë* të kishës. Zakonisht familjen e tillë e zgjidhte fshati, ose fisi dhe kryefamiljarin ia prezantonin kryemurgut. Vojvoda ka pasur për detyrë që, në emër të fisit ose të fshatit, ta mbrojë kishën në rast nevojë, duke rrezikuar edhe jetën e vet. Në kishën e Deçanit *vojvoda* ka pasur edhe një dhomë të caktuar ku ai banonte e ruante ditë e natë. Kjo dhomë ka qenë e vendosur përmbi derën e oborrit. Kur kërcënohej ndonjë rrezik këtu bënin roje disa vetë nga ky fshat. Pozita e vojvodës trashëgohej nga e njëjta familje, derisa mos ta ndërronte fshati ose fisi.” (Mark Krasniqi, Rojtarët e kishave në Kosovë, *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë 1979). Nga këto kisha më të njohurat janë: Kisha e Deçanit, Patrikana e Pejës dhe Kisha e Deviçit në Drenicë.

2.4. Mbiemrat sipas nofkës a llagapit

Edhe mbiemrat që janë nofkë a llagap i ndonjë paraardhësi të bartësit të mbiemrit janë nga më të ndryshmit.

2.4.1 Të formuar sipas ndonjë tipari a vesi, kemi këta mbiemra:

Abrashi, Çallakaj, Çallaki, Çallaku, Çollakaj, Çollaki, Çollaku, Qallaku; Çela, Çelaj; Dallaveraj, Dallaveri; Doradreja, Dorambari, Gervalla, Gërvalla; Gunga, Gjashtgishti, Mashkulli, Meraku, Kallaba, Kërveshi, Kopalla, Kopili, Kryeziu, Paçarizi, Parashumti, Plaku, Qafëleshi, Qafleshi; Qorri, Qorraj; Qosa, Qosaj, Qosja; Shkurti, Shurdha, Shurdhaj, Shurdhani, Shurdhiqi; Tapalli, Topalli, Topallaj, Topërlaku, Tullumi, Veçgishti, Vesvesja, Vorfi, Xhahnemi [sipas N. Xh., 1991, e kanë dashur shumë të nxehurit dimrit me dru].

Mbiemri *Abrashi* (179) – Sipas Malush Abrashit (59 vjeç), nga Gjakova, me vendbanim në Zvicër, ky mbiemër u ka mbetur ngase lija (variola) kishte lënë gjurmë te njeri prej paraardhësve të tij dhe nga atëherë e kanë marrë mbiemrin Abrashi. Sipas Fjalorit të Gjuhës shqipe: *abrash* – me flokë e vetulla të bardheme; me preka në fytyrë (për njerëz). Prekë – shenja a gropëza që lë lija në fytyrë. (Fjalori i gjuhës shqipe, 2006).

Mbiemri *Gunga* (55), që e bartin disa familje me origjinë nga Gjakova, sipas Korab Gungës (46 vjeç, nga Prishtina) rrjedh nga koha kur një i parë i tyre rrezohet në kokë dhe për pasojë i del "gunga" dhe i mbetet nofka (ofiqi) 'gungani', e cila pastaj si 'Gunga' bëhet mbiemri i një pjese të familjes që më parë quhej Perjuci. Pjesa tjetër e familjes edhe sot e mban mbiemrin Perjuci, mbiemër ky i cili mendohet se lidhet me lagjen e "Paruces" të qytetit të Shkodrës.

Mbiemri *Kopalla* (37) – Sipas Muhamet Kopallës, nga Obrança e Podujevës, një paraardhës i kësaj familjeje paska qenë shakaxhi i dalluar dhe në bazë të tij fillimisht është përdorur thënia "Hajde mos na qit kopalla si Beqa i mëhallës..." dhe kështu thuhet se është regjistruar familja e tij me mbiemrin Kopalla. Ja trangu i kësaj familjeje: Muhameti – Zeqiri – Tahiri – Xheladini – Beqiri/Beqa.

Mbiemri *Xhahnemi* (18) – Sipas Urim Xhahnemit të parët e tyre kishin pasur zakon të blejnë shumë dru për dimër e populli kur i ka parë se sa shumë dru kanë marrë, kanë thanë "ooo qe paskan bo Xhahnem" dhe nga kjo u ka mbetur ky llogar, i cili më vonë është shndërruar në mbiemër.

- 2.4.2 Mbiemrat të formuar sipas ndonjë pjese të trupit të njeriut (por dhe që mund të mos kenë lidhje me to) janë:

Barku, Grushti, Qafa, Koka/Kokaj etj.

- 2.4.3 Mbiemrat të formuar sipas ndonjë gjësendi të përdorimit të përditshëm (por dhe që mund të mos kenë lidhje me to, por të jenë emër i shkurtër i ndonjë të pari, a emër i fshatit të prejardhjes) janë:

Baraku, Bardaku, Baruti, Bisaku, Çakmaku, Dajaku, Fylli, Furra, Gajtani, Kamishi, Kaçamaku, Kapixhiku, Kapuçi/Kapuqi, Koçani, Krypa (janë marrë me tregtinë e krypës/kripës), *Sheqeri* (janë marrë me tregtinë e sheqerit), *Kuburja, Lima, Llulla, Pallaska, Pitarka, Pushka, Shporta*.

- 2.4.4 Mbiemrat të formuar sipas ndonjë shtaze, shpendi a insekti (por dhe që mund të mos kenë lidhje me to) janë:

Bleta, Bylbyli, Daci, Dashi, Demi (mund të jetë edhe diminutiv i *Ademi*), *Dreni, Gjeli, Knusi, Kenduesi, Korbi, Luani, Peshku, Pula* (fshat në Shqipëri), *Piliqi* (turq. zog *pule*), *Shotani, Taraku, Zogu*.

Mbiemri *Dashi* – Sipas Ismail Dashit (57 vjeç), nga fshati Stagovë i Kaçanikut, ky mbiemër u ka mbetur, se sipas traditës në anët e tyre, kur kanë shkuar në ndenja i kanë marrë me vete deshtë për ‘me i përle’ (për mundje). Trungu i kësaj familjeje: Ismail – Xhezair – Latif – Shabedin.

Nga Vahide Dashi-Kelmendi prej Peje: Mbiemri na ka mbetur prej të parëve tanë. Kishte qenë një vëlla me shumë motra dhe nga 'dashnia' që kanë pasur motrat ndaj vëllait, nuk e kanë thirrur kurrë në emër, por "dashi i motrës" dhe nga këtu atij i ka mbetur nofka "Dashi", të cilën familja më vonë e ka marrë si mbiemër të vetin. Ka mjaft familje me mbiemrin "Dashi", por familja jonë nuk ka lidhje farefisnore me ato familje, përveç njëres nga Gjakova.

Mbiemri *Peshku* – Sipas Emin Peshkut nga fshati Barilevë afër Prishtinës, me fis Berishë, ky mbiemër u ka mbetur se familja e tyre ka zënë shumë peshk në lumin Llap dhe e kanë terur (tharë) kështu kur ndonjë udhëtar ka kërkuar konak i kanë drejtuar te këta për arsye ushqimi dhe gjithmonë udhëtarët kanë thanë ‘bonum konak te Peshku’.

Mbiemri *Shotani* – Sipas Bekim Shotanit nga Vushtrria këtë mbiemër e kanë marrë se kanë pasur shumë shota.

Mbiemri *Daci* – Sipas Gëzim Dacit: Prejardhja e familjes së tyre është nga fshati Dacaj i Rozhajës, prej nga e kanë marrë edhe mbiemrin. Thuhet se në Dacaj kanë ardhur nga fshati Sello i Shqipërisë.

2.4.5 Mbiemrat të formuar sipas ndonjë bime a pjese të bimës (por dhe që mund të mos kenë lidhje me to) janë:

Dushku, Kalaveshi, Karpuzi (turq. ‘Shalqini’), *Mollakuqe* (edhe vend në ish Sanxhakun e Nishit), *Shalqini, Tërshana*.

2.4.6 Mbiemrat të formuar sipas ndonjë kombi tjetër (por dhe që mund të mos kenë lidhje me ta) janë:

Arap, Boshnjaku, Çerkezi, Gorani, Malazezi, Malziu, Maqedonci (sipas vendit prej nga kanë ardhur), *Maxhari* (nga fshati Maxharrë, komuna e Malishevës), *Misiri, Turku, Vllasi*.

Në lidhje me prejardhjen e mbiemrit *Boshnjaku* (425) mbase është me interes të përmendim këtu mendimin e Idriz Ajetit që ka dhënë në punimin e tij “Rreth Vehbijes së Tahir efendi Boshnjakut” (Ajeti, 1960). Ajeti thotë se “autori i Vehbijes Tahir efendi Boshnjaku ka prejardhje nga Sanxhaku, d.m.th. nga Rrafshnaltja e Peshterit, prindërit e të cilit kanë dalë në këto anë tona në fund të shekullit 17, apo në fillimet e tetëmbëdhjetëshit”. Por ai, po këtu, e përmend edhe mendimin e Hasan Kaleshit se mbiemri ‘Boshnjaku’ i Tahir efendi Boshnjakut” të ketë mbetur prejse myderriz Tahiri e kishte bërë zakon të shtegtonte nëpër vise të Bosnes, për ç’gjë mori emrin *Boshnjak*.”

2.5. Mbiemrat matronimikë

2.5.1 Etimologjia e mbiemrit **Havolli** (656)

Familjet Havolli jetojnë në Fshatin Llapashticë e Epërme në komunën e Podujevës. Ky fshat është autokton dhe ka afërsisht 500 familje të shtrira në mëhallë të cilat për nga afërsia e gjakut janë vëllezër dhe të një fisi (Gash). Sipas gojëdhënës etimologjia e mbiemrit Havolli rrjedh nga emri i gruas së vejë, Havës, të vëllait më të madh nga shtatë vëllezërit që e përbëjnë Llapashticën e Epërme dhe atë të Poshtme. Ky paraardhës i familjeve të sotme Havolli, është mobilizuar në ushtrinë osmane dhe ka marrë pjesë në luftërat e Lindjes së Largët dhe për shkathtësi dhe trimëri luftarake është

graduar në komandant. Në njerën prej këtyre luftërave ka vdekur. Gruaja e tij ka mbetur për t'u kujdesur për katër fëmijët jetimë, të cilët kanë filluar të quhen Hava-ogli (djemtë e Havës), prej nga Havolli. Për t'ia lehtësuar jetën dhe për t'i mundësuar që t'i rrisë fëmijët jetim asaj (Havës) pushteti osman ia ka ndërtuar një kullë dhe një mulli në Podujeve. Mulliri është edhe sot dhe quhet Mullini i Havollit, ndërkaq kulla është rrënuar në vitin 1942. Mëhallët e tjera, mixhallarët e 4 djemve të Havës, janë: Cakiqi (nga Caka), Hakiqi (nga Haka), Muqiqi (nga Muqaj) dhe Potera [tregoi: Ymer Havolli]. Edhe Llutolli (Lutoglu, bijtë e Lutës) janë të një barku me këta [sipas Samir Poterës].

2.5.2 Etimologjia e mbiemrit **Maraj** (269)

Sipas një varianti, të treguar nga Rexhep Maraj, edhe këtu kemi të bëjmë me matronim. Është gojëdhënë e paverifikuar se gjoja në Vrellë të Istogut ka 'zbarkuar' motra Mara, me vëllezërit Bila dhe Ndrela, të fisit Kastrat, prej nga mbiemrat Maraj, Bicaj dhe Dreshaj. Që të gjithë janë kushërinj dhe nuk janë martuar mes vete kurrë. Shumë më vonë kanë ardhur Krasniqja e Rugovajt etj. Ja dhe trangu i kësaj familjeje: Rexhepi – Bardhi – Lati – Avdiu (Avdiu) – Arifi – Meta. Edhe varianti tjetër, i treguar nga Milazim Maraj, po nga ky fshat, është i ngjashëm, vetëm se sipas tij kemi të bëjmë me patronim, nga vëllai Mari, e jo nga motra Mara. Ky e jep edhe një variant tjetër, sipas të cilit mbiemri *Maraj* ka mbetur nga "kodrat e mbuluara përgjysmë me borë, të quajtura 'mara' ose nga bima 'maraj' (maraq), një lloj kopre e egër, e cila përdoret për shërimin e disa sëmundjeve.

2.5.3 Matronime të tjera

Shembuj të matronimeve hasim sidomos në Gjakovë, si p.sh.: *Hasimja* (85) – sipas një të veje, me emri Hasime, e cila i ka rritur e vetme të tre djemtë e vet, të cilët kanë filluar t'i quajnë 'djemtë e Hasimes' (Ermal Hasimja).

Edhe mbiemri *Bedra* (62) që e mbajnë disa familje nga Gjakova dhe më gjerë është matronim – sipas një gruaje të vejë me emrin Bedrije, e cila po ashtu i ka rritur e vetme të tre fëmijët e vet (Arllati & Rogova, 2015, f. 76).

Matronime, me gjasë janë edhe mbiemrat: *Naka* – nga Nakije, *Feta* – nga Fetije, *Xhiha* – nga Naxhije etj. (Arllati & Rogova, 2015, f. 77/78)

Matronim mund të jetë edhe mbiemri *Foniqi* (344). Sipas një varianti që e tregon Shaqir Foniqi (65 vjeç, nga Prishtina) njëfarë Mehmeti kishte qenë i martuar me një femër të krishterë (katolike), me të cilën kishte pasur shumë fëmijë dhe fshati kishin krijuar thënien ‘po shkojmë te djemtë e foneshës’, dhe nga aty u kishte mbetur mbiemri Fona. Në të kaluarën ‘fandë’ a ‘fanë’ dhe ‘fonë’, sipas krahinës Fan të Mirditës (emri i vjetër *Fandë*) të Shqipërisë, janë quajtur shqiptarët e besimit katolik. Variantet e tjera të prejardhjes së mbiemrit *Foniqi*, po dhe *Fana* (151) e *Fanaj* (284), *Fona* (25) e *Fonaj* (4) dhe *Fonda* (23) e *Fondaj* (71) lidhen me vendin e prejardhjes së familjeve që bartin këta mbiemra. Familje me mbiemrin *Foniqi* ka në Llazicë të Klinës, Arllat të Drenasit dhe në Dobërçan te Gjilanit.

3. NJËQIND MBIEMRAT MË TË SHPESHTË NË KOSOVË DHE PËRNDARJA E TYRE GJEOGRAFIKE

Në fund të punimit jepet tabela me 100 mbiemrat e parë në Kosovë dhe 100 mbiemrat e parë në Shqipëri, të renditur sipas numrit të paraqitjes në korpuset e marra në shqyrtim.

Nga tabela, shohim se nga dhjetë (10) mbiemrat e parë në Kosovë (me denduri 6.8‰-29.84‰): *Krasniqi*, *Gashi*, *Berisha*, *Shala*, *Morina*, *Bytyçi/Bytyqi*, *Hasani*, *Hoxha*, *Rexhepi*, *Kastrati*, shtatë (7) prej tyre tregojnë ‘përkatësinë’ fisnore të bartësve të këtyre mbiemrave, ndaj nuk është çudi që shpesh në organizata të ndryshme hasim të punësuar disa vetë me mbiemrin *Krasniqi* a *Gashi*, por që nuk janë në lidhje familjare me njëri-tjetrin, madje dhe nga treva të ndryshme të Kosovës. Në 12-shën e parë hyjnë edhe *Thaqi* (4.78)/*Thaçi* (2.2) dhe *Hoti* (6.77).

Po ashtu vlen të theksohet se mbiemrat sipas fisit i gjejmë te të dy konfesionet (mysliman e katolik), që tregon për ndjenjën e përkatësisë të përbashkët të afërt.

Më poshtë po japim listën e 100 mbiemrave të parë në Kosovë, të radhitur sipas renditjes alfabetike:

Abazi, *Ademaj*, *Ademi*, *Ahmeti*, *Ajeti*, *Aliu*, *Arifi*, *Asllani*, *Avdiu*, *Avdyli*, *Azemi*, *Bajraktari*, *Bajrami*, *Balaj*, *Behrami*, *Beqiri*, *Berisha*, *Bislimi*, ***Brahimi***, *Bunjaku*, *Bytyçi*, *Bytyqi*, ***Demiri***, *Elshani*, *Emini*, *Fazliu*, *Gashi*, *Hajdari*, *Hajdini*, ***Halili***, *Halimi*, *Haliti*, ***Hasani***, *Hashani*, *Haziri*, *Hoti*, ***Hoxha***, *Hyseni*, *Ibishi*, *Ibrahimi*, *Idrizi*, *Imeri*, *Islami*, *Ismajli*, *Isufi*, *Jakupi*, *Jashari*, *Kabashi*, *Kadriu*, *Kastrati*, *Kelmendi*,

*Krasniqi, Kryeziu, Latifi, Maliqi, Maloku, Mazreku, **Mehmeti**, Miftari, Morina, **Murati**, Musa, Musliu, Mustafa, Neziri, Osmani, Peci, Pllana, Qerimi, **Rama**, Ramadan, Rashiti, **Rexha**, Rexhaj, Rexhepi, Rrahmani, Sadiku, Sahiti, Salihu, Sejdiu, Selimi, Selmani, **Sinani**, **Spahiu**, Syla, Sylejmani, Shabani, Shala, Shaqiri, **Shehu**, Tahiri, Thaçi, Thaqi, Uka, Ukaj, Veseli, Zeka, **Zeneli**, Zeqiri, Zogaj*

Ndër 100 mbiemrat e parë më të shpeshtë në Kosovë, 37 janë patronime, d.m.th. sipas emrit të një paraardhësi, prej të cilëve prijnë:

Bajram (1135), Ramadan (956), Rexhep (830), Shaban (825), Ali (822), Adem (674), Hasan (661), Ahmet (630), Muharrem (558), Mehmet (544), Halil (465), Ibrahim (449), Idriz (447), Hamdi (441), Hysen (441), Sadik (420), Isuf (411), Osman (405), Kadri (392), Imer (383), Qazim (368), Selim (363), Tahir (355), Islam (344), Beqir (338), Haxhi (334), Sylë (324), Sadri (322), Brahim (311), Ramiz (309) etj., - emra këta të të shpeshtë në Kosovë para vitit 1939 (Caka & Caka, 2009).

Nga krahasimi i kësaj liste me listën e 100 mbiemrave të parë në Shqipëri, të radhitur sipas renditjes alfabetike (Bedollari):

Abazi, Agolli, Aliaj, Alikaj, Andoni, Arapi, Balla, Bardhi, Basha, Begu, Berberi, Bezhani, Brahimi, Bushati, Cani, Çausi, Çela, Dangëllia, Deda, Dede, Dedja, Demiri, Dervishi, Dibra, Duka, Duro, Elezi, Frashëri, Gjata, Gjergji, Gjika, Gjoka, Gjoni, Halili, Hana, Hasa, Hasani, Haxhiu, Hoxha, Hysi, Jaho, Jaupi, Kaleshi, Kamberi, Kanani, Kasa, Koçi, Kodra, Koka, Kola, Kondi, Kote, Kraja, Kristi, Laçi, Lako, Laze, Leka, Luarasi, Luka, Madhi, Malaj, Marku, Meçe, Mehmeti, Mema, Mezini, Muço, Mulo, Murati, Myftiu, Myslimi, Niko, Nikolla, Osmani, Pano, Papa, Peçi, Prifti, Rama, Rexha, Ruçi, Saraçi, Shalsi, Shehu, Shtylla, Shyti, Sinani, Skënderi, Spahiu, Sula, Thanasi, Toska, Treska, Vata, Xhafa, Xhani, Ymeri, Zaimi, Zeneli,

shohim se në të dy listat na dalin vetëm 15 mbiemra:

Abazi, Brahimi, Demiri, Halili, Hasani, Hoxha, Mehmeti, Murati, Osmani, Rama, Rexha, Shehu, Sinani, Spahiu, Zeneli.

Nga krahasimi i këtyre listave, shohim po ashtu se në Kosovë shumica nga 100 mbiemrat e parë janë trerrokësh (74/100), e pasojnë ata dyrrrokësh (21/100) dhe katërrrokësh (5/100). Në Shqipëri, ndërkaq, shumica nga 100 mbiemrat e parë janë dyrrrokësh (63/100), e pasojnë ata trerrokësh (35/100) dhe katërrrokësh (2/100).

PËRFUNDIM

Mbiemrat a emrat familjarë të shqiptarëve në Kosovë kanë ndjekur rrugën e formimit sikurse te popujt e tjerë evropianë, nga emri i një të pari të tyre, nga vendi prej nga kanë ardhur ose nga profesioni a grada që kanë pasur ose nga ndonjë ofiq a ngallap i cili është shndërruar në emër familjar a mbiemër, por hasim aty-këtu edhe disa veçanti, si formimi i mbiemrave prej dy a më shumë emrave të përngjitur, e që tregon vjetërsinë e këtyre mbiemrave, *Demjaha* (Demë + Jaha), *Hasanmetaj* (Hasan + Metë), *Prenkolnikaj* (= Prenë + Kolë + Nikë) etj. Kemi pak emra edhe nga emri i ndonjë gruaje të njohur (matronime), si p. sh. *Havolli* (= bijtë e Havës). Në Kosovë haset edhe dukuria e vënies së emrit të burrit emrit të vajzërisë së gruas, si p.sh. Blerta *Deliu-Kodra*, *Mimoza Kusari-Lila* etj.

Një pjesë e madhe e mbiemrave haset në të gjitha trevat e Kosovës, por disa prej tyre dalin më shumë në një trevë të caktuar, si mbiemrat me *-aj* a me dy emra të përngjitur, që janë karakteristikë për anën e Deçanit, apo mbiemrat me *-olli* që janë karakteristikë, p.sh. për fshatin Marec të Prishtinës, ndonëse hasen edhe gjetiu.

Në dallim nga Shqipëria, në Kosovë kemi fare pak mbiemra që mbarojnë me *-e* ose *-o*.

Numri i personave të përfshirë në këtë punim është rreth 1.330.000, prandaj rezultatet e paraqitura në këtë këtë punim kanë të bëjnë me këtë bazë të të dhënave.

Shënim:

Autorët ftojnë të gjithë ata që dëshirojnë që mbiemrat e tyre të shpjegohen drejt t'ua dërgojnë autorëve (në adresën elektronike ali.caka@gmail.com, nebi.caka@gmail.com) variantin e tyre të shpjegimit të mbiemrave të vet, së bashku me trungun e familjes.

REFERENCES / LITERATURA:

- Ajeti, Idriz (1960), “*Pamje historike e ligjërit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*”, Rilindja, Prishtinë, 1960, në *Vepra 2*, ASHAK, 1998.
- Arllati, Migena dhe Rogova, Muhamet. (2015), *Patronimet në Gjakovë – mbiemrat, emrat familjarë*, Shoqata e intelektualëve “Jakova, Gjakovë, 2015.
- Begolli, Mithat. Q. (2015), *Mahmutbegollët e Pejës – Kontribut për gjenealogji*, Prishtinë, 2015.
- Bidollari, Çlirim (2001) “Për një fjalor patronimik të shqipes”, *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë-Prizren, gusht 2000; Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, 2001.
- Caka, Ali dhe Caka, Nebi (2009), “*Mbiemrat e sotëm të shqiptarëve të Kosovës*”, *AKTET*, Vol. 3, Nr. 4, f. 565-569a.
- Caka, Nebi dhe Caka, Ali (2009), “*Motivimi i emërtimeve të fëmijëve në Kosovë 1912-2008*”, *AKTET*, Vol. 3, Nr. 4, f. 554-556-A-F.
- Dizdari, Tahir (2005), *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, AIITC, Tiranë, 2005.
- Luccheti, E., Mikerezi, I., Memushi, L., Bajrami, Z. (1997), “Një studim paraprak rreth shpërndarjes së mbiemrave në bazë të abonentëve telefonikë të Shqipërisë”, *Antropologjia e shqiptarëve*, Tiranë, 24-26 tetor 1997, p. 119-126.
- Krasniqi, Mark (1979), *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike*, *Onomastika e Kosovës*, Prishtinë, 1979.
- Krasniqi, Mark (1984), *Lugu i Baranit*, monografi etnogjeografike, Prishtinë, 1984.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës. https://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=2810
- Shkurtaj, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe linguistikë*, Tiranë: Shblu, 2001.
- Thomai, Jani etj. (2006), *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, ASHSh, Tiranë, 2006
- Uka, Sabit (2004), *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë, 1877/1878-1912, Ribotimi i dytë; Prishtinë*.
<http://www.pustareka.org.rs/naselja.htm>

Ali CAKA, Prishtina
Nebi CAKA, Prishtina

ORIGIN AND REGIONAL DISTRIBUTION OF KOSOVO ALBANIAN SURNAMES

Summary

Albanian surnames, unlike the surnames of other Europeans, are relatively recent. During the Yugoslav Kingdom, the majority of Kosovo Albanians were forced by the regime to add Slavic suffix *-iq* or *-viq* to their surnames. After the Second World War, Kosovo Albanians have been allowed to change their surnames, and most of them have done so. Most of today's surnames of the Albanian families in Kosovo are from that time. The surname change is allowed by law even today and we have cases of surname changes even after the last war in Kosovo, i.e. after 1999. This paper reviews the surnames from various population registries, accounting for about 1,500,000 different persons. The surnames are classified and 100 most frequent surnames of Kosovo Albanians are presented, which are compared with 100 most frequent surnames in Albania. The origin of some typical surnames is explained by the owners. The survey has been conducted by email with persons of both genders aged between 20 and 70. They were asked to provide the origin of their surnames and possibly the family tree. A number of answers have been given in this paper, and the other answers will be used in a monograph on the same topic. The answers in most of cases are family "official versions" since respondents were consulted with the other members of the family, usually father and grandfather, but also oldest uncle. The majority of respondents have given a family tree that in some cases goes to 15 generations, which includes a period of 500 years. Some of them have also given their tribal affiliation.

Finally the paper provides a regional distribution of 100 most frequent surnames of Kosovo Albanians.

Key-word: Albanian surnames, surname classification, origin of family names, top 100 Albanian surnames

Kosovë (Caka & Caka)				Shqipëri (Bidollari)			
Nr.	Mbiemri	Nr.	Mbiemri	Nr.	Mbiemri	Nr.	Mbiemri
1.	Krasniqi	51.	Bajraktari	1.	Hoxha	51.	Mehmeti
2.	Gashi	52.	Uka	2.	Shehu	52.	Niko
3.	Berisha	53.	Abazi	3.	Prifti	53.	Osmani
4.	Morina	54.	Azemi	4.	Çela	54.	Pano
5.	Shala	55.	Arifi	5.	Leka	55.	Bardhi
6.	Bytyqi	56.	Musliu	6.	Dervishi	56.	Cani
7.	Hasani	57.	Miftari	7.	Hysi	57.	Deda
8.	Kastrati	58.	Islami	8.	Rama	58.	Demiri
9.	Hoxha	59.	Imeri	9.	Dibra	59.	Hasa
10.	Rexhepi	60.	Spahiu	10.	Abazi	60.	Kasa
11.	Hoti	61.	Neziri	11.	Sinani	61.	Mema
12.	Bajrami	62.	Ismajli	12.	Gjika	62.	Myftiu
13.	Kryeziu	63.	Halimi	13.	Kola	63.	Peçi
14.	Mehmeti	64.	Zogaj	14.	Kraja	64.	Shtylla
15.	Hyseni	65.	Thaçi	15.	Luka	65.	Toska
16.	Shabani	66.	Asllani	16.	Duka	66.	Treska
17.	Ahmeti	67.	Bunjaku	17.	Gjoka	67.	Ymeri
18.	Osmani	68.	Rexha	18.	Murati	68.	Zaimi
19.	Ramadani	69.	Ajeti	19.	Kristi	69.	Bezhani
20.	Aliu	70.	Veseli	20.	Mulo	70.	Dedja
21.	Mustafa	71.	Shehu	21.	Muço	71.	Duro
22.	Ademi	72.	Murati	22.	Andoni	72.	Kamberi
23.	Thaqi	73.	Zeneli	23.	Hasani	73.	Kote
24.	Salihu	74.	Avdyli	24.	Koçi	74.	Laçi
25.	Sadiku	75.	Emini	25.	Frashëri	75.	Laze
26.	Jashari	76.	Avdiu	26.	Ruçi	76.	Malaj
27.	Tahiri	77.	Mazreku	27.	Zeneli	77.	Marku
28.	Rama	78.	Zeka	28.	Papa	78.	Hana
29.	Ibrahimi	79.	Kadriu	29.	Spahiu	79.	Shyti
30.	Beqiri	80.	Jakupi	30.	Balla	80.	Skënderi
31.	Syla	81.	Pllana	31.	Bushati	81.	Berberi
32.	Sylejmani	82.	Rrahmani	32.	Gjoni	82.	Dede
33.	Kelmendi	83.	Sinani	33.	Brahimi	83.	Elezi
34.	Zeqiri	84.	Brahimi	34.	Kanani	84.	Gjergji
35.	Hajdari	85.	Rexhaj	35.	Alikaj	85.	Jaupi
36.	Haliti	86.	Balaj	36.	Arap	86.	Koka
37.	Maliqi	87.	Idrizi	37.	Çausi	87.	Kondi
38.	Kabashi	88.	Demiri	38.	Halili	88.	Luarasi
39.	Halili	89.	Hajdini	39.	Thanasi	89.	Vata
40.	Elshani	90.	Ademaj	40.	Xhafa	90.	Meçe
41.	Sejdiu	91.	Behrami	41.	Aliaj	91.	Nikolla
42.	Isufi	92.	Hashani	42.	Basha	92.	Rexha
43.	Selimi	93.	Musa	43.	Mezini	93.	Saraçi
44.	Maloku	94.	Bislimi	44.	Sula	94.	Xhani
45.	Haziri	95.	Peci	45.	Agolli	95.	Dangëllia
46.	Bytyçi	96.	Qerimi	46.	Gjata	96.	Shalsi
47.	Selmani	97.	Ukaj	47.	Haxhiu	97.	Madhi
48.	Fazliu	98.	Ibishi	48.	Jaho	98.	Begu
49.	Sahiti	99.	Shaqiri	49.	Kodra	99.	Myslimi
50.	Latifi	100.	Rashiti	50.	Lako	100.	Kaleshi

Nr	Mbiemri	Gjithsej	Deçan	Gjakovë	Glogovc	Gjilan	Dragash	Istog	Kaçanik	Klinë	Fushë Kosovë	Kamenicë	Mitrovicë	Leposaviq	Lipjan	Novobërdë	Obiliq	Rahovec	Pejë	Podujevë	Prishtinë	Prizren	Skenderaj	Shtime	Shtërpçë	Suharekë	Ferizaj	Viti	Vushtrri	Zveçan	Zubin Potok	Malishevë
1.	KRASNIQI	39642	881	1776	1503	439	855	52	731	913	1030	865	173	1	1421	4	1293	3400	3568	463	6474	5159	174	390	7	1359	716	50	1536			4409
2.	GASHI	39514	121	1186	1893	125	284	420	821	3275	449	54	466		2174	49	378	2441	4077	1709	7431	3915	1013	619	7	3286	710	144	291		1	2175
3.	BERISHA	30824	670	1858	869	499	495	453	1493	2489	1018	463	473	1	521	1	395	1651	4172	1485	4297	3116	175	17	4	1379	898	70	399			1463
4.	MORINA	18446	15	1515	1275	306		171	10	1371	45	1406	215		106		107	3088	918		786	2620	73	5	4	912	40	5	332			3121
5.	SHALA	18434	887	1486	735	642	111	130	10	402	308	99	638		703		218	757	3220	490	1716	2363	903	17		1053	343	3	531			669
6.	BYTYQI	10490	29	419	820	12	1	31	10	65	90		16		1037		22	771	315	2	523	2373	85	63	7	1832	846	7	5			1109
7.	HASANI	9660	19	345	180	871	283	37	126	75	133	82	1359	1	169		38	40	141	1078	1025	230	474	172	51	83	1017	627	868	96		40
8.	KASTRATI	9398	33	324	581	479		46	21	101		1489	35		71		48	1223	1358	700	536	841	99	2	1	18	90	3	65			1234
9.	HOXHA	9126	142	644	756	486	1	47	197	11	55	32	87		333		22	356	287	654	778	1370	244	252	1	608	485	315	77			886
10.	REXHEPI	9031	3	164	212	1698	83	3	170	60	87	218	420		407	5	119	310	114	594	1258	166	324	155	54	4	1343	919	140			1
11.	HOTI	8996	22	787	251	180	1	52		475	42	209	250		137		72	2623	204	710	427	532	462	7		228	9		43			1273
12.	BAJRAMI	8849	16	432	183	1100	303	12	197	21	97	167	256	12	249	16	66	120	225	435	1212	884	314	424	72	85	981	584	324			62
13.	KRYEZIU	8572		377	18	254	590	1	12	94	18	899	2		186			1025	125		262	1566	2	6	1	1217	86	2	7			1822
14.	MEHMETI	8480	1	358	198	912	211	13	8	65	83	66	672	2	291	46	218	9	125	888	1299	87	417	327	58		896	287	880	61	1	1
15.	HYSENI	8071	3	116	97	749	79	20	16	9	167	164	730		237	9	64	10	166	886	929	200	263	397	81	20	769	524	1365			1
16.	SHABANI	8050	1	174	98	1059	138	31	59	21	118	334	456		251	4	84	147	77	812	643	218	493	340	94	58	1337	612	388			3
17.	AHMETI	7989	6	556	89	746	382	9	24	6	51	305	679		261	49	41	115	261	418	1158	111	550	291	55	100	877	437	408			4
18.	OSMANI	7428		169	121	848	213	45	121	3	217	105	766		168	24	32	20	33	459	1243	442	520	83	20	144	797	261	571		1	2
19.	RAMADANI	7270	8	23	221	1208	575		50	6	50	165	202		296	1	11	201	29	257	897	309	248	441	47	300	1124	544	33			24
20.	ALIU	7092		29	59	1145	128	2	51	3	56	58	534	1	373	1	172	70	609	1187	108	418	96	116	76	911	448	435		2		4
21.	MUSTAFA	7085	3	109	31	807	330		29	108	88	63	506		218	124	122	306	84	599	895	250	269	173	23	132	671	409	732		3	1
22.	ADEMI	6376		120	151	327	49	1	54	103	92	17	599		202		17	36	126	456	977	316	201	161	79	20	876	536	850			10
23.	THAQI	6359	114	787	805	29	11	11	166	171	16	472	34		109		103	882	483	54	224	896	247	1	1	30	160		26			527
24.	SALIHU	6234	38	189	32	1038	119	9	100	39	60	57	365		404		100	28	21	494	626	80	146	273	12	70	905	513	515			1
25.	SADIKU	5997	6	247	17	462	159	1	9	4	30	159	834		291	1	107	55	209	292	694	133	144	160	12	117	904	369	535			46
26.	JASHARI	5776	1	9	35	417	27	9	10	7	136	18	699		275	3	86		18	845	760	120	449	181	1	190	863	184	432			1
27.	TAHIRI	5363	21	278	60	353	133	3	6	52	31	134	1043		104	3	23	22	118	514	529	88	441	42	53	136	629	165	378	2	1	1
28.	RAMA	5018	1	497	212	54		2	1	81	52	62	487		135		62	136	210	503	755	313	399	90	3	1	311	275	358	17		1
29.	IBRAHIMI	4887	1	214	54	895	216	2	18	5	99	57	377		323	2	177	119	43	319	696	168	49	19	3	43	457	280	176		2	73
30.	BEQIRI	4797	2	37	61	344	81	17	34	59	54	86	821		37	22	63	54	161	185	792	46	259	45		1	528	482	503			23
31.	SYLA	4720	22	430	117	654		28	1	71	46	27	458		128		57	19	68	445	664	45	301	139	7		240	314	431	7		1
32.	SYLEJMANI	4697		24	43	797	181		6	2	82	119	283		233	3	24	84	104	426	657	212	51	25	87		510	699	33			12
33.	KELMENDI	4677	25	65	16	3		69		62	256	23	461		87		136	294	2103	1	482	201	76	15		32	19	1	42		1	207
34.	ZEQIRI	4645	6	125	35	647	2	8	12	81	74	28	318		301	103	28	193	88	571	621	33	122	199	1	118	423	238	265	2		3
35.	HAJDARI	4523	7	378	331	591	66	24	95	33	22	117	461		44		48	4	86	307	382	180	166	15	11	308	265	380	184		5	13
36.	HALITI	4281		12	33	573	68	39	4	45	48	25	270		154	16	67	58	108	638	413	98	208	44	21	41	771	236	288		1	2
37.	MALIQI	4255	1	81	42	805	132	1	75		73	1077	132		82	17	10	52	15	247	459	58	83	49		25	326	335	77			1
38.	KABASHI	4211	5	199	7			662	2	60	10		111					811	188	1	74	924	282	7		833	14	2	3			16
39.	HALILI	4176	2	125	24	456	125	7	34	22	46	36	172		65		15	62	65	439	397	72	144	217	62	18	500	342	605			124
40.	ELSHANI	4098	1	11	770		2	62		57	20		39		17		34	616	140		83	924	12	5		1052		4				249
41.	SEJDIU	4077		19	74	384		8	16	91	40	10	323		114		19		9	504	503	6	326	38		9	1084	288	211			1
42.	ISUFI	3907	8	229	198	792	50	2	7	16	2	384	448		160	13	52		57	90	423	7	172	109	14	24	408	76	164			2
43.	SELIMI	3884	4	57	2	685	125	7	60	78	47	70	261		68	3	45	4	53	141	617	57	276	33	12	114	512	288	181	24		60
44.	MALOKU	3868	208	107	84	393	1	20		81	11	57	80		25		35	1	70	716	516	168	4	17		38	525	3	505			203
45.	HAZIRI	3860	1	61	21	742		3	5	30	77	10	294		164		82		3	318	553	10	164	117	17	19	366	479	324			
46.	BYTYCI	3819		5	19			138	1	2	9		7		299			75	104	3	138	306	27	2		1905	204					575
47.	SELMANI	3768	3	90	115	398	217	1	130	79	25	43	314		113	27	51	35	59	464	507	79	109	123	27		368	294	91			6
48.	FAZLIU	3696		4	81	318	21	10	96	23	53	139	242		144		92	130	11	642	568	27	201	179	3	3	285	121	302			1
49.	SAHITI	3571		98	117	394	21	38	11	25	61	6	332		224		20	57	65	142	472	23	158	60	26		648	333	157			83
50.	LATIFI	3538		4	34	566	82	1	11		61	78	404		49	5	8	32	51	757	530	95	90	77	1	10	134	89	369			

Nr	Mbiemri	Gjithsej	Deçan	Gjakovë	Glogovc	Gjilan	Dragash	Istog	Kaçanik	Klinë	Fushë Kosovë	Kamenicë	Mitrovicë	Leposiviq	Lipjan	Novobërdë	Obiliq	Rahovec	Pejë	Podujevë	Prishtinë	Prizren	Skenderaj	Shitme	Shtrëpcë	Suharekë	Ferizaj	Viti	Vushtrri	Zveçan	Zubin Potok	Malishevë	
51.	BAJRAKTARI	3493	31	99	302		58	123	13	347	2	1	125		205			217	202	76	153	206	359	4	4	466	412	2	26			60	
52.	UKA	3492	1	187	72	56	27	1	6	31	60	2	653		172	4	28	8	52	553	532	144	193	42	45		95	152	326	49	1		
53.	ABAZI	3455		63	1	384	96	14	11	14	29	64	253		9	43	51	21	101	259	527	141	259	159		115	354	265	222				
54.	AZEMI	3444		11	6	401	11		1	2	84	29	469		141	2		17	547	427	10	153	50	14			466	301	301			1	
55.	ARIFI	3431	1	145	3	755	125	3	22	11	32	66	133	1	238	36	5	2	48	213	589	223	24	75	87		273	208	112		1		
56.	MUSLIU	3382	1	12	123	648	20	3	3	9	24	43	319		15	3	80		4	348	586	55	245	43	13	5	458	176	146				
57.	MIFTARI	3363	15	142	78	430	113	6	19	15	37	16	496		77		55	102	39	275	428	139	222	54			169	209	226			1	
58.	ISLAMI	3336	3	119	35	301	7		35	2	93	33	355		41		10		55	492	525	104	102	9	46	1	482	295	189		1	1	
59.	IMERI	3232	10	147	145	80	88	16	35	40	22	43	397	1	70	22	4	61	23	311	293	90	283	81	47	1	258	184	460	18		2	
60.	SPAHIU	3211		29	130	386	71	4	85	3	10	403	42		176		2	497	51	73	241	228	357	32		89	226	3	22			51	
61.	NEZIRI	3159	2	153	117	420	57	20	54	1	30	32	124		93	1	14	48	153	180	416	76	105	96		4	534	287	138		2	2	
62.	ISMAJLI	3147		19	22	349	1	2	25	2	79	232	103		75	1	139	4	14	130	362		96	105	21		410	705	251				
63.	HALIMI	3077		5	5	649	473		9		57	35	60		85	11	55	4	3	383	347	133	130	100	17		226	255	35				
64.	ZOGAJ	3025	36	15	121	5		351		114	44		2		101			16	214		94	324	5	2		164	15					1402	
65.	THACI	2929	17	23	191	21	19	3	204	30	14	170	45		102		75	300	84	98	195	386	272			7	70	1	30			572	
66.	ASLLANI	2875	4	281	18	242	137	1	17	35	30	4	275		91		71	27	51	171	329	76	162	111	13	31	468	28	198			4	
67.	BUNJAKU	2862	1	96	44	668		1	172	6	8	391	94		5	31	6		8	228	434	23		6			19	8	613				
68.	REXHA	2861	2	471	48	59		4	273	12	10	100	142		24	1	7	186	19	61	394	274	162	167	3	11	218	9	143			61	
69.	AJETI	2819		10	5	644	14		19		20	57	18		180		7		6	369	598	10	94	31	29		244	412	52				
70.	VESELI	2797	1	109	63	300	36	2	4	73	63	59	351		39	1		93	144	50	256	89	233	119		14	367	90	192	47		2	
71.	SHEHU	2702	212	323	113	70			487	1		39	5				2	324	41		192	469	2		13	125	234				50		
72.	MURATI	2671		38		366	170	1	22	3	39	42	154		67	2	25		120	285	230	396	71	8	16	12	370	69	163			2	
73.	ZENELI	2629		138	40	131	25	2	223	57	8	1	355		145		40	55	46	260	397	7	99	24	15	5	111	197	246			2	
74.	AVDYLI	2617	2	185	164	176	44		6	31	16	40	65		175	30	4	24	212	96	218	139	78	79	8	27	574	183	41				
75.	EMINI	2589	1	17	45	304	218	1	18	4	49	12	137	8	101		64	18	3	203	292	89	48	226	8		286	391	45			1	
76.	AVDIU	2555	25	19	10	129	45		6	31	43	8	348		92		11	1	13	180	413	14	343	81	37	10	249	248	138			61	
77.	MAZREKU	2505		12	1	3				4	2				18		1	843	10		10	443				175	3					980	
78.	ZEKA	2482		241	174	38		1	2	13	20	13	103		52		36	214	184	348	470	8	147	17		1	111	87	202				
79.	KADRIU	2464		3	5	390		8	2	19	61	53	233		103		18	55	2	293	420	24	280	118		1	231	6	137			2	
80.	JAKUPI	2413	2	94	23	395	88	4	72	70	9	145	42		36		20	19	57	169	287	65	37	221	8	87	189	213	43	18			
81.	PLLANA	2407		10				1		1	190		551		16		278		4	70	601		1	1			1	682					
82.	RAHMANI	2389	1	39	10	274	46	3	20	2	13	2	159		212		10	1	26	474	368	10	69	55	52	15	236	188	86	7		11	
83.	SINANI	2353		3	30	129	221	1	12		6	76	77		208		4	96	33	455	228	60	178	39	14	4	137	181	161				
84.	BRAHIMI	2319	1	62	121	44	2	19	9	21	9	5	798		51		26		64	36	215	9	140	121	25	5	311	115	110				
85.	REXHAJ	2267	66	149	14			450	2	26		2	2		4				470	1	55	529	7	256			122	93				19	
86.	BALAJ	2242	600	158	24	9		383		219	2		17					2	72	20	128	147	49	7		360	19	1	16			9	
87.	IDRIZI	2234	2	122	1	297	52	6	145	26	27	25	140		4		4		99	163	146	110	124	7	32		327	284	91				
88.	DEMIRI	2224	1	34	52	417	49	7	8	58	19	44	12		194			9	4	84	150	206	155	27		105	234	296	55			4	
89.	HAJDINI	2195		5	144	303			4	9	40	10	153	1	116		33		8	132	450	5	88	28			316	183	163		4		
90.	ADEMAJ	2142	41	219			1	379			4		5		1		1	1	492	15	50	579		330			19		1			4	
91.	BEHRAMI	2125		1	98		10	1		5	7		494		2		92		6	516	168		396				1		327			1	
92.	HASHANI	2097			1	44			52			124	5	1	171		555				249	95			3	1	17	777	1	1			
93.	MUSA	2065	2	161		22	47	4		76	11	8	375		1	1	12	1	82	290	145	14	35		6	5	340	100	325	1		1	
94.	BISLIMI	2019	1			306	68		8			47	5	115		116		29	5		93	293	19	101	131	15	2	377	283	5			
95.	PECI	2018		1				7			2	2	1798				1				65	1	4						132		5		
96.	QERIMI	1982		47	14	644	50		1		41	1	23		62		5		1	242	105	1	43	75	8	1	348	167	103				
97.	UKAJ	1971	359	318	3	2		297		40	6		3		25			159	141	3	47	386	7	9		41	11	91			2	21	
98.	IBISHI	1936		36	1	83		2	3	37	66	22	427		5			3	78	162	221	41	93	3			310	105	238				
99.	SHAQIRI	1916		5		416	22	6	19	4	14	16	73		37	1	19		14	9	202	44	229	144	16	12	175	240	198			1	
100.	RASHITI	1911			15	726	24				10	47	15		123				5	158	188	22	5	319			70	183			1		